



# ARSIMI JOFORMAL PËR FËMIJËT PARASHKOLLORE



Program praktik për prindërit e fëmijëve  
në moshën parashkollore të komunitetit afgan në Shëngjin



**Florian Kulla**

**Aurela Zisi**

# **ARSIMI JOFORMAL**

## **PËR FËMIJËT PARASHKOLLORE**

**PROGRAM PRAKTIK PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE NË MOSHËN PARASHKOLLORE TË  
KOMUNITETIT AFGAN NË SHËNGJIN**

Titulli: Arsimi joformal për fëmijët parashkollorë

Autorë: Florian Kulla, Aurela Zisi

Punimi grafik: Artemida Hinaj

Copyright©YWCA of Albania

Viti i botimit: 2024

YWCA of Albania:

Rruga “Him Kolli”, Nd. 13, Tiranë

Ky manual u realizua në kuadër të projektit “Qendra Ditore si hapësirë kreative dhe e sigurtë”, implementuar nga UNICEF Albania me mbështetjen e qeverisë së SHBA dhe në partnership me YWCA of Albania.

## Pasqyra e lëndës

<b>HYRJE</b>	<b>7</b>
<b>Çfarë ofron ky manual</b>	<b>7</b>
<b>Përfitimet për ju dhe fëmijët tuaj</b>	<b>8</b>
<b>Si mund të ndihmoni fëmijët tuaj</b>	<b>8</b>
<b>Si të kujdeseni për fëmijët dhe veten në kohëra të vështira</b>	<b>9</b>
<b>Kujdesi për veten</b>	<b>10</b>
<b>ÇFARË ËSHTË ARSIMI JO-FORMAL</b>	<b>10</b>
<b>Pse është i dobishëm arsimi jo-formal për fëmijët e zhvendosur</b>	<b>11</b>
<b>Si ndihmon arsimi jo-formal fëmijët e zhvendosur</b>	<b>11</b>
<b>Pse janë të rëndësishme qendrat e lojërave</b>	<b>12</b>
<b>Pse janë të rëndësishme arti dhe kultura në arsimin jo-formal</b>	<b>12</b>
<b>Qendrat e lojërave dhe përfitimet për fëmijët e zhvendosur</b>	<b>13</b>
<b>Shembuj të aktiviteteve në qendrat e lojërave</b>	<b>13</b>
<b>SI TË KRIJONI NJË MJEDIS TË QETË DHE STIMULUES PËR FËMIJËN TUAJ</b>	<b>13</b>
<b>Pse është e rëndësishme që fëmija të ndiejë përkatësi</b>	<b>14</b>
<b>Si t’i ndihmoni fëmijët të ndihen më të përfshirë</b>	<b>14</b>
<b>Si të krijoni një rutinë të qëndrueshme për fëmijët</b>	<b>14</b>
<b>Si të krijoni një mjedis të përshtatshëm për mësim</b>	<b>14</b>
<b>Si të mbështesni fëmijët në aktivitete të përditshme</b>	<b>15</b>
<b>Aktivitetet sportive dhe moti</b>	<b>16</b>
<b>Roli i prindërve në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve parashkollorë</b>	<b>16</b>
<b>Kokë më kokë</b>	<b>16</b>

Edukimi i vlerave njerëzore	17	LOJA Nr. 15. Rritemi së bashku	47
Edukimi atdhetar	18	LOJA Nr. 16. Notim në oqean	48
Veprimtari praktike për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve	21	LOJA Nr. 17. Prek dhe zbulo	49
Me librin pranë	22	LOJA Nr. 18. Gjej shokun!	50
Përrallat dhe historitë për fëmijët në moshën parashkollore	23	LOJA Nr. 19. Mbledhja e thesareve	51
Zhvillimi i imagjinatës	25	LOJA Nr. 20. Krijo botën tënde	51
Zhvillimi i të menduarit të fëmijëve	25	LOJA Nr. 21. Koha për zbulim	53
Veprimtari për zhvillimin e të menduarit	26	LOJA Nr. 22. Këndet e zbulimit	54
Veprimtari praktike për zhvillimin emocional të fëmijëve	28	LOJA Nr. 23. Ndihmo gjarprin të gjejë miq	55
Ndërtimi i marrëdhënieve dhe i aftësive sociale	29	LOJA Nr. 24. Modelo dhe krijo	56
Veprimtari praktike për zhvillimin fizik të fëmijëve	32	LOJA Nr. 25. Ngjyrosim zogjtë	58
Lojëra dhe aktivitete	32	LOJA Nr. 26. Argëtim me lodrat dhe mjetet e mësimi	59
LOJA Nr.1. Ritet e mëngjesit dhe të pasdites	32	LOJA Nr. 27. Kukullat për argëtim me pupeta	60
LOJA Nr. 2. Lëvizje për të nisur ditën - Zgjoje trupin tënd	33	LOJA Nr. 28. Kukullat e gëzimit për duar	61
LOJA Nr. 3. Si thonë kafshët përshëndetje	34	LOJA Nr. 29. Bëjmë kafshë te karta dhe luajmë me to	62
LOJA Nr. 4. Përmbledhja e pasdites	35	LOJA Nr. 30. Bëjmë tupanë dhe eksperimentojmë me tinguj	62
LOJA Nr. 5. Loja e tregimeve - Tregimet e shkurtra për fëmijët	36	LOJA Nr. 31. Shkopinj të muzikorë	63
LOJA Nr. 6. Histori me zë dhe lëvizje	37	LOJA Nr. 32. Daullja e zhurmave	64
LOJA Nr. 7. Në rrugë për në kopsht	38	LOJA Nr. 33. Krijo topin dhe unazën	65
LOJA Nr. 8. Këndo, luaj dhe lëviz	39	LOJA Nr. 34. Puzzle nga kartoni	66
LOJA Nr.9. Ecim dhe kërcejmë me litar	40	LOJA Nr. 35. Blloqe ndërtimi	67
LOJA Nr. 10. Kalimi i topit dorë m'ë dorë	42	LOJA Nr. 36. Gjej çiftet e sakta	68
LOJA Nr. 11. Kush e zbraz kutinë më shpejt	43	LOJA Nr. 37. Maskat e kafshëve	69
LOJA Nr. 12. A mund ta bësh çfarë bëj unë	44	Bibliografia	72
LOJA Nr. 13. Udhëtimi i aventurave	45		
LOJA Nr. 14. Brenda dhe jashtë	46		





## HYRJE

Ky manual është shkruar për t'ju ardhur në ndihmë juve, prindër të komunitetit afgan, të mbështesni fëmijët tuaj të vegjël në këtë periudhë të rëndësishme të jetës së tyre. Duke qenë larg vendit tuaj dhe në përballje me sfida të reja, e kuptojmë se për ju është e rëndësishme që të krijoni një mjedis të sigurt dhe të ngrohtë për fëmijët tuaj. Qëllimi i këtij manuali është t'ju udhëzojë se si të mbështesni zhvillimin dhe edukimin e tyre, duke përdorur aktivitete të thjeshta dhe lojëra të përshtatura për moshën parashkollore. Arsimi është një e drejtë për çdo fëmijë, dhe pavarësisht situatave të vështira, mund të krijoni mundësi të mëdha për ta edhe përmes arsimit jo-formal. Kjo formë e arsimit përfshin aktivitete që mund t'i zhvilloni në shtëpi, duke i ndihmuar fëmijët të mësojnë dhe të zhvillojnë aftësi të reja në mënyrë argëtuese dhe të thjeshtë. Lojërat, këngët dhe aktivitetet krijuese mund të jenë mjete të fuqishme për t'i ndihmuar fëmijët të mësojnë për botën që i rrethon dhe të forcojnë aftësitë e tyre sociale e emocionale.

Në këtë manual do të gjeni këshilla dhe udhëzime se si të zhvilloni aktivitete e dhe për fëmijët tuaj. Ju nuk keni nevojë për shumë mjete apo lodra të shtrenjta – mjafton dashuria dhe kujdesi që tregoni për fëmijët tuaj, si dhe përfshirja aktive në aktivitetet që do të bëni së bashku. Do t'ju tregojmë se si lojërat e thjeshta me objekte të jetës së përditshme mund të ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë imagjinatën, komunikimin, aftësitë motorike dhe mendimin kritik.

Arsimi jo-formal është i dobishëm, sepse i ndihmon fëmijët të mësojnë në mënyrë fleksible, jashtë kufijve të një klase të zakonshme. Përmes këtij manuali do të mësoni se si të krijoni një mjedis të sigurt, mbështetës dhe pozitiv për fëmijët tuaj, ku ata mund të ndihen të mbrojtur dhe të përgatiten për një të ardhme më të mirë.

Ju inkurajojmë të merrni pjesë aktivisht në edukimin e fëmijëve tuaj, duke përdorur këto teknika të thjeshta, por të efektshme për moshën e tyre. Pavarësisht vështirësive që keni kaluar, është e mundur të ndërtoni një të ardhme më të mirë për fëmijët tuaj, duke filluar me këto hapa të vegjël, por të rëndësishëm. Ju jeni shembulli i parë dhe më i rëndësishëm për fëmijët tuaj, dhe çdo hap që bëni për t'i mbështetur ata, ka një ndikim të madh në të ardhmen e tyre.

### Çfarë ofron ky manual

Ky manual përmban aktivitete të thjeshta që mund t'i përdorni në shtëpi, në këndet e lojërave apo në mjedise të tjera të përshtatura pranë vendit ku jetoni. Aktivitetet janë krijuar për të ndihmuar fëmijët

tuaj të vegjël në moshën parashkollore të zhvillojnë aftësi të reja dhe për t'u dhënë mundësi për të mësuar përmes lojës. Disa nga aktivitetet përfshijnë:

- ☆ Lojëra që ndihmojnë në përmirësimin e aftësive të të folurit dhe të menduarit.
- ☆ Lojëra për të mësuar ngjyrat, format dhe numrat.
- ☆ Aktivitete që i ndihmojnë fëmijët të lidhen me të tjerët dhe të socializohen më mirë.

### Përfitimet për ju dhe fëmijët tuaj

Me këto lojëra dhe aktivitete, fëmijët tuaj do të ndihen më të sigurt, më të gëzuar dhe më të përgatitur për shkollën. Ata do të zhvillojnë aftësi të reja që do t'i ndihmojnë të përballen me sfidat e jetës së përditshme. Ky manual ju jep udhëzime praktike dhe ide për t'ju ndihmuar të krijoni një mjedis të ngrohtë dhe të stimulues për ta. Përmes aktiviteteve të sugjeruara ju do të mësoni si të ndihmoni fëmijët tuaj të zhvillohen dhe të ndihen të mbështetur.

Ky manual është krijuar për t'ju ndihmuar të përballeni me sfidat që keni si familje e zhvendosur dhe për të ndihmuar fëmijët të ndërtojnë një të ardhme më të mirë. Me dashurinë dhe përkushtimin tuaj, ju mund të jeni një mbështetje e fortë për ta në këtë periudhë të rëndësishme të jetës së tyre.

### Si mund t'i ndihmoni fëmijët tuaj

Lojërat janë mënyra më e mirë për t'i mësuar fëmijët. Nëpërmjet lojës, fëmijët fitojnë aftësi të reja dhe zbulojnë botën përreth tyre. Kur luajnë, ata mësojnë të flasin më mirë, të mendojnë dhe të bashkëpunojnë me të tjerët. Kur ju luani me ta, i ndihmoni të zhvillohen dhe të ndihen të lumtur.

Fëmijët e zhvendosur nga jeta dhe vendbanimi i tyre i zakonshëm kanë nevojë për një program të qëndrueshëm të përditshëm. Krijimi i një rutine u jep atyre ndjenjën e sigurisë dhe të qetësisë në një mjedis të ri. Kjo i ndihmon fëmijët të ndihen më të organizuar dhe më të gatshëm për të përballuar ndryshimet.

Fëmijët kanë nevojë të ndihen të sigurt dhe të mbështetur nga ju. Kur ndihen të dashur dhe të mbrojtur, mësojnë më lehtë dhe përballen më mirë me sfidat e përditshme. Gjithashtu, fëmijët që marrin mbështetje emocionale, janë më të përgatitur për të krijuar marrëdhënie pozitive me të tjerët. Kujdesi për fëmijët mund të jetë i vështirë, sidomos në kushte të reja dhe të vështira.

Është e rëndësishme të jeni të duruar dhe të tregoni mirëkuptim ndaj nevojave të tyre. Mos ngurroni të kërkonin ndihmë kur ju nevojitet, qoftë nga komuniteti apo familjarët tuaj.

Fëmijët tuaj mund të ndihen të pasigurt në fillim për shkak të ndryshimeve. Me kalimin e kohës, duke u dhënë dashuri dhe kujdes, ata do të ndihen më të sigurt dhe do të kenë më shumë besim tek ju dhe tek vetja e tyre.

### Si të kujdeseni për fëmijët dhe veten në kohëra të vështira

Si prindër, ju jeni përballur me sfida të mëdha, dhe është e kuptueshme që mund të ndjeni stres dhe lodhje. Kujdesi për fëmijët është gjithmonë i vështirë, por në kohëra të vështira, kjo përgjegjësi bëhet edhe më e rëndë. Është e rëndësishme të kujtoni që nuk jeni vetëm në këtë rrugëtim. Ndjenjat e lodhjes dhe shqetësimit janë normale. Jepini vetes kohë për të ndërtuar një marrëdhënie të fortë me fëmijët tuaj dhe mos hezitoni të kërkonin mbështetje kur ju nevojitet.

Komunikimi dhe ndarja e përvojave me të tjerët mund të sjellë një ndryshim të madh.

Në kohë të vështira, durimi është një nga cilësitë më të rëndësishme që mund të keni si kujdestar. Kujdesi për fëmijët kërkon shumë energji dhe mund të ndiheni të lodhur ose të mbingarkuar. Mos harroni që është normale të ndiheni kështu dhe se të gjithë bëjmë gabime. Jepini vetes kohë për të rilindur besimin me fëmijët tuaj dhe përqijuni të ruani një frymë mirëkuptimi. Flisni me të tjerët dhe pranoni ndihmën e miqve ose të anëtarëve të komunitetit kur ju nevojitet.

Mbajtja e komunikimit të hapur dhe të drejtë është shumë e rëndësishme për të ndërtuar marrëdhënie të forta me fëmijët dhe të tjerët përreth. Sigurohuni që të gjithë të ndihen të respektuar dhe të mirëpritur, duke shmangur krahasimet mes familjeve ose fëmijëve. Çdo prind/kujdestar dhe çdo fëmijë është i rëndësishëm dhe duhet trajtuar njësoj, me dashuri dhe vëmendje.

Fjalët pozitive kanë një ndikim të madh si tek ju, ashtu edhe tek fëmijët tuaj. Lavdëroni përpjekjet e tyre, edhe kur progresi është i vogël.

Kur fëmijët bëjnë përparim, vlerësojini dhe ndihuni krenarë për arritjet e tyre. Po ashtu, organizoni aktivitete ku mund të bashkoheni me prindër të tjerë dhe të ndiheni të mbështetur në grup, duke ndarë përvoja dhe sfida.

Të qëndroni të qetë dhe të vetëdijshëm është e rëndësishme si për ju, ashtu edhe për fëmijët tuaj. Përdorni teknika të thjeshta të qetësisimit për t'u relaksuar dhe për të ndihmuar fëmijët të përballen me stresin. Angazhohuni në aktivitete që mund të jenë të dobishme për të gjithë, si tregimi i historive, punimet artizanale ose mësimi i aftësive të reja. Kjo do të ndihmojë jo vetëm fëmijët, por edhe ju, si prindër/kujdestarë, të gjeni një balancë më të mirë në përditshmëri.



Dëgjoni fëmijët tuaj dhe jini të duruar me ta. Mos u irritoni shpejt dhe mos premtuni gjëra që nuk mund t'i mbani. Prekjet dashamirëse, si përqaqimet, mund të jenë një mënyrë e mirë për t'i qetësuar ata, por kujdesuni që disa fëmijë mund të jenë më të ndjeshëm ndaj këtyre gjesteve. Kushtojuni vëmendje reagimeve të tyre dhe tregoni dashamirësi pa i vënë në siklet.

Nëse përballeni me raste të vështira, si neglizhenca ose abuzimi, është e rëndësishme të qëndroni të paanshëm dhe të ofroni mbështetje pa gjykim. Çdo situatë është unike dhe meriton të trajtohet me kujdes dhe mirëkuptim.

### Kujdesi për veten

Mos harroni se, për t'u kujdesur për fëmijët, duhet të kujdeseni edhe për veten. Të kujdesesh për të tjerët është shumë e rëndësishme, por nëse ju nuk kujdeseni për veten, do të jetë e vështirë të jini të fortë dhe të qëndrueshëm për fëmijët. Gjeni kohë për të pushuar dhe për të marrë veten.

Si kujdestarë, ju luani një rol të pazëvendësueshëm në jetën dhe mirëqenien e fëmijëve tuaj. Duke qenë pranë tyre, duke i dëgjuar dhe duke u krijuar një mjedis mbështetës dhe të ngrohtë, ju i ndihmoni ata të përballen me sfidat e jetës me më shumë siguri dhe vetëbesim. Kujdesi dhe dashuria janë baza mbi të cilën ata mund të ndërtojnë një të ardhme më të mirë.

## ÇFARË ËSHTË ARSIMI JO-FORMAL

Arsimi jo formal zakonisht fillon që nga mosha e hershme, shpesh duke u integruar në aktivitete të ndryshme që i shërbejnë zhvillimit të fëmijëve përtej/jashtë arsimit formal. Kjo mund të përfshijë programe të ndryshme edukative dhe aktivitete që nuk janë pjesë e kurrikulës formale shkollë. Për fëmijët, arsimi jo formal shpesh është një mundësi për të zhvilluar aftësi që mund të mbështesin dhe përforcojnë punën që bëhet në kopsht/qendra ditore, ndërkohë që nxit kreativitetin dhe individualitetin. Në shumë raste, arsimi jo-formal ofron mundësi për të mësuar duke bërë, duke u angazhuar dhe eksploruar në një mjedis më të lirë dhe më pak të strukturuar.

Të mësuarit për fëmijët refugjatë është i rëndësishëm, pasi ky proces ndikon jo vetëm në zhvillimin e tyre intelektual, por edhe në integrimin e tyre në mjedisin e ri dhe në ruajtjen e identitetit kulturor. Rëndësia e këtij procesi është e lidhur me:

**Zhvillimin e gjuhës.** Në emigracion, fëmijët parashkollorë shpesh ndodhen mes dy ose më shumë gjuhëve, ku ndjekin mësimin në gjuhën e vendit pritës dhe ruajnë gjuhën e vendit të origjinës. Mësimi

në moshë të hershme i ndihmon ata të zhvillojnë aftësi gjuhësore më të mira, duke përmirësuar komunikimin, kuptimin dhe ndërveprimin me bashkëmoshatarët dhe mësuesit. Kjo ndihmon edhe në zhvillimin e aftësive njohëse dhe të shprehjes emocionale.

Duke lexuar libra, kënduar këngë dhe folur në gjuhën amtare në shtëpi, prindërit mund të ndihmojnë që fëmijët të ruajnë gjuhën dhe kulturën e tyre origjinale.

**Ruajtjen e identitetit kulturor.** Fëmijët refugjatë janë të ekspozuar ndaj një kulture dhe tradite të ndryshme. Përfshirja e elementeve të kulturës së tyre në procesin e të mësuarit i ndihmon ata të ruajnë lidhjen me rrënjët e tyre, duke kontribuar në ndërtimin e identitetit të tyre kulturor. Kjo ndikon në zhvillimin emocional dhe në vetëbesimin e tyre. Aktivitetet e larmishme dhe ndërkulturore ndihmojnë fëmijët të njohin dhe respektojnë kulturat e tjera, duke përforcuar edhe vlerat e kulturës së tyre.

**Inkurajimi i miqësive dhe i ndërveprimit.** Fëmijët duhet të kenë mundësinë të luajnë dhe të bashkëpunojnë me bashkëmoshatarët në mënyrë që të zhvillojnë aftësitë sociale dhe ndjenjën e përkatësisë në grupin ku ndodhen.

**Zhvillimin social dhe emocional.** Fëmijët refugjatë mund të përjetojnë sfida të ndryshme emocionale për shkak të largimit nga ambienti i njohur dhe nga të afërmit. Mësimi në një mjedis të sigurt, mbështetës dhe multikulturor ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit dhe ndjenjës së përkatësisë. Mësuesit dhe prindërit kanë një rol të rëndësishëm për të krijuar një atmosferë pozitive dhe mbështetëse në të cilën fëmijët ndihen të pranuar dhe të mbështetur në përpjekjet e tyre.

### Pse është i dobishëm arsimi jo-formal për fëmijët e zhvendosur

Arsimi jo-formal është i dobishëm, sepse aktivitetet e tij mund të përshtaten me nevojat e fëmijëve që kanë kaluar sfida të vështira. Kjo i ndihmon ata të ndihen të përfshirë dhe të zhvillojnë aftësi të reja, edhe në rrethana të vështira. Përmes lojërave dhe aktiviteteve, fëmijët kanë mundësinë të lidhen më mirë me bashkëmoshatarët e tyre dhe të mësojnë më shpejt gjuhën dhe kulturën e vendit të ri. Arsimi jo-formal, gjithashtu, u ofron fëmijëve mbështetje emocionale, duke i ndihmuar të ndihen më të sigurt dhe të përgatitur për shkollën dhe jetën e re.

### Si ndihmon arsimi jo-formal fëmijët e zhvendosur

Arsimi jo-formal është një mënyrë e njohur për fëmijët që të mësojnë jashtë kopshtit/shkollës. Fëmijët mund të mësojnë përmes lojërave dhe aktiviteteve të ndryshme, të cilat zhvillohen në qendra

komunitare, klube sportive ose grupe të vogla. Kjo qasje e të mësuarit i ndihmon fëmijët të mësojnë duke luajtur dhe duke bashkëpunuar me të tjerët, në një mjedis të relaksuar dhe pa stresin e vlerësimit. Nëpërmjet arsimit jo-formal, fëmijët kanë një vend të sigurt ku mund të luajnë, të mësojnë dhe të shprehin ndjenjat e tyre, pa frikë apo presion. Lojërat i ndihmojnë të zhvillojnë aftësitë e komunikimit, mendimin kritik dhe bashkëpunimin me të tjerët. Kjo i ndihmon të përgatiten për shkollë me më shumë vetëbesim. Aktivitetet, gjithashtu, i ndihmojnë të lidhen me shokët e rinj dhe të ndihen pjesë e komunitetit të ri, duke përmirësuar integrimin e tyre.

### Pse janë të rëndësishme qendrat e lojërave

Qendrat e lojërave janë të rëndësishme, sepse ndihmojnë fëmijët të përgatiten për shkollë, duke mësuar përmes aktiviteteve dhe lojërave. Ato ofrojnë një mjedis të sigurt ku fëmijët mund të shprehin ndjenjat e tyre dhe të ndërtojnë miqësi. Gjithashtu, në këto qendra, fëmijët përfitojnë mbështetje gjuhësore dhe emocionale, duke u ndihmuar të përballojnë sfidat e traumës dhe të zhvendosjes. Për të qenë të suksesshme, këto shërbime duhet të jenë të sigurt dhe të udhëhiqen nga njerëz të trajnuar, duke respektuar rregullat e shëndetit dhe të sigurisë. Këto qendra krijojnë një mjedis të rehatshëm për fëmijët, ku ata mund të zhvillohen nga ana emocionale, sociale dhe akademike. Këto aktivitete dhe shërbime do t'i ndihmojnë fëmijët tuaj të ndihen më të sigurt, më të përgatitur për shkollën dhe më të përfshirë në shoqërinë e re.

### Pse janë të rëndësishme arti dhe kultura në arsimin jo-formal

Arti dhe kultura luajnë një rol të rëndësishëm në arsimin jo-formal, sidomos për fëmijët që kanë përjetuar sfida si zhvendosja/largimi i detyruar nga vendi i tyre. Përmes artit dhe aktiviteteve kulturore, fëmijët mund të shprehin ndjenjat e tyre për përvojat e vështira, si largimi nga shtëpia. Kjo i ndihmon të largojnë stresin dhe të ndihen më të qetë. Gjithashtu, këto aktivitete u mësojnë fëmijëve gjëra të reja, duke i ndihmuar të ruajnë dhe të respektojnë kulturën e tyre, por edhe të njohin dhe respektojnë kulturat e tjera.

Arti dhe kultura ndihmojnë fëmijët të ndihen pjesë e shoqërisë ku jetojnë tani, duke marrë pjesë në aktivitete që i lidhin me të tjerët dhe i ndihmojnë të kuptojnë më mirë kulturat e ndryshme. Përmes këtyre aktiviteteve, fëmijët mësojnë të respektojnë dhe të bashkëpunojnë me shokët e tyre, pavarësisht prejardhjes. Këto përvoja i ndihmojnë të forcojnë vetëbesimin dhe t'i përballojnë më mirë sfidat e përditshme.

### Qendrat e lojërave dhe përfitimet për fëmijët e zhvendosur

Fëmijët tuaj, që kanë përjetuar sfida si zhvendosja dhe emigrimi, kanë nevojë për mbështetje emocionale dhe sociale. Qendrat e lojërave ofrojnë hapësira të sigurt ku fëmijët mund të luajnë, të mësojnë dhe të krijojnë besim në vetvete. Këto qendra janë një mjedis i ngrohtë ku fëmijët ndihen të mbështetur dhe të mirëpritur.

### Shembuj të aktiviteteve në qendrat e lojërave

- ☆ Prindërit lexojnë së bashku me fëmijët, duke forcuar lidhjen me ta dhe duke inkurajuar dashurinë për të mësuarit.
- ☆ Fëmijët dhe prindërit mund të krijojnë lojëra sipas fantazisë së tyre, duke zhvilluar kreativitetin dhe aftësitë praktike.
- ☆ Fëmijët mund të marrin lodra me vete për t'i përdorur edhe në shtëpi.
- ☆ Fëmijët mësojnë përmes lojës, duke u argëtuar dhe duke zhvilluar aftësitë e tyre.
- ☆ Fëmijët dhe prindërit marrin pjesë bashkarisht në aktivitete edukative dhe argëtuese.
- ☆ Prindërit mund të ndajnë përvojat e tyre dhe të diskutojnë së bashku për mënyrat më të mira për të ndihmuar fëmijët.
- ☆ Prindërit marrin këshilla të dobishme për edukimin dhe mbështetjen e fëmijëve, në bashkëpunim me shërbimet e komunitetit.

### SI TË KRIJONI NJË MJEDIS TË QETË DHE STIMULUES PËR FËMIJËN TUAJ

Një nga mënyrat më të mira për të mbështetur fëmijët, sidomos ata në moshën parashkollore, është të krijoni një mjedis të qetë ku ata mund të luajnë dhe të mësojnë. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që të ndërtoni marrëdhënie të forta me fëmijët tuaj, t'i ndihmoni të ndihen të mbrojtur dhe t'i siguron se janë të sigurt me ju.

Në situata të vështira, si zhvendosja nga vendi i tyre ose përballja me konfliktin, fëmijët mund të ndihen të shqetësuar dhe të frikësuar. Disa fëmijë mund të kenë vështirësi në gjumë, të bëhen më të ndjeshëm ose më të tërhequr. Ky është një reagim normal ndaj situatave të pazakonta. Fëmijët më të vegjël mund të shfaqin frikë më shpesh, ndërsa fëmijët më të mëdhenj mund të shfaqin sjellje më agresive ose të izolojnë nga të tjerët.



Si prind, ju keni një rol të rëndësishëm në mbështetjen e fëmijëve tuaj gjatë periudhave të vështira. Mbështetja emocionale është thelbësore. Sigurohuni që fëmijët tuaj të kenë një rutinë të qëndrueshme dhe të qetë, pasi kjo u jep ndjenjën e stabilitetit. Aktivitetet krijuese dhe lojërat mund t'i ndihmojnë fëmijët të shprehin emocionet e tyre dhe të ndihen më të sigurt.

### Pse është e rëndësishme që fëmija të ndiejë përkatësi

Fëmijët që janë zhvendosur shpesh ndihen të shkëputur nga komuniteti dhe familja. Kjo ndodh për shkak të humbjes së strukturave mbështetëse që ata kanë pasur më parë. Si prind, ju mund të ndihmoni fëmijët të rindërtojnë ndjenjat e tyre të përkatësisë duke i bërë ata të ndihen pjesë e komunitetit të ri. Kjo mund të arrihet përmes lojërave, aktiviteteve kulturore dhe sportive, të cilat ndihmojnë fëmijët të ndihen të mirëpritur dhe të pranuar nga të tjerët.

### Si t'i ndihmoni fëmijët të ndihen më të përfshirë

Lojërat, artet dhe aktivitetet kulturore janë mjete të fuqishme që ndihmojnë fëmijët të lidhen me të tjerët dhe të ndihen pjesë e një komuniteti të ri. Këto aktivitete i ndihmojnë fëmijët të shprehin emocionet e tyre dhe të forcojnë zhvillimin social dhe emocional. Duke marrë pjesë në këto aktivitete dhe duke marrë mbështetjen tuaj, fëmijët do të ndihen më të sigurt dhe më të përgatitur për të përballuar sfidat e jetës.

### Si të krijoni një rutinë të qëndrueshme për fëmijët

- ☆ Diskutoni dhe krijoni orarin e përshtatshëm së bashku me fëmijët.
- ☆ Përdorni vizatime dhe figura për ta bërë orarin më të kuptueshëm për ta.
- ☆ Sigurohuni që fëmijët të kuptojnë orarin duke përdorur gjuhë të ndryshme, nëse është e nevojshme.
- ☆ Ndërroni aktivitetet duke përdorur kartolina ose mjete kreative për të mbajtur fëmijët të angazhuar.
- ☆ Përditësoni orarin rregullisht dhe bëni ndryshime sipas nevojës.
- ☆ Krijoni një kuti ku fëmijët mund të vendosin idetë e tyre për aktivitete të reja.

### Si të krijoni një mjedis të përshtatshëm për mësim

Për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për mësim për fëmijët parashkollorë, është e rëndësishme të përfshini aktivitete ditore që mbështesin zhvillimin e tyre fizik, emocional dhe social. Disa nga aktivitetet që mund të përfshini janë:

- ☆ **Ritualet e mëngjesit dhe të pasdites,** Këto rituale ndihmojnë fëmijët të ndihen të sigurt dhe të stabilizuar gjatë gjithë ditës.
- ☆ **Tregimet, Leximi i tregimeve** ndihmon në zhvillimin e gjuhës, të fantazisë dhe të aftësive për të dëgjuar e biseduar.
- ☆ **Këngët dhe kërcimi.** Aktivitetet muzikore ndihmojnë në shprehjen emocionale dhe përmirësimin e lëvizjeve trupore.
- ☆ **Sportet dhe lojërat.** Lojërat fizike ndihmojnë në zhvillimin e aftësive motorike dhe bashkëpunimin me të tjerët.
- ☆ **Ngjyrosja dhe vizatimi.** Këto aktivitete inkurajojnë kreativitetin dhe i ndihmojnë fëmijët të përmirësojnë koordinimin sy-dorë.
- ☆ **Loja e lirë:** I ndihmon fëmijët të marrin vendime dhe të bëhen më të pavarur.
- ☆ **Artizanati.** Krijimi i objekteve ndihmon në zhvillimin e motorikës fine dhe të aftësive krijuese. Këto aktivitete krijojnë një mjedis të pasur që ndihmon fëmijët të mësojnë në mënyrë argëtuese dhe të zhvillojnë aftësi të rëndësishme për jetën.

### Si të mbështesni fëmijët në aktivitete të përditshme

- ☆ **Përshtasni aktivitetet sipas nevojave.** Çdo fëmijë është i ndryshëm. Nëse një aktivitet duket i vështirë, përpuni ta bëni më të lehtë ose ta përshtatni për t'i ndihmuar të gjithë të marrin pjesë.
- ☆ **Përdorni lojëra, këngë dhe vizatime** për të mbajtur vëmendjen e fëmijëve dhe për t'i ndihmuar të kuptojnë më mirë.
- ☆ **Krijoni një mjedis të qetë dhe të pastër.** Fëmijët kanë nevojë për një mjedis të qetë, të sigurt dhe të pastër për të mësuar më mirë.
- ☆ **Menaxhoni sjelljet e tyre me disiplinë pozitive.** Vendosni rregulla të thjeshta dhe shpjegojuni fëmijëve pse ato janë të rëndësishme. Lavdërojini kur sillen mirë dhe ndihmohuni të kuptojnë ndjenjat e tyre.
- ☆ **Përballoni dhe menaxhoni konfliktet.** Nëse ndodh një konflikt, ndërhyini me qetësi dhe ndihmohuni fëmijët të gjejnë një zgjidhje paqësore.

## Aktivitetet sportive dhe moti

Sigurohuni që aktivitetet sportive të jenë të sigurta. Për shembull, shmangni lojërat e rrezikshme si vrapimi i shpejtë ose kërcimi mbi objekte të larta. Gjithashtu, kujdesuni për motin; gjatë verës, ofroni hije dhe shumë ujë, ndërsa në dimër aktivitete të shkurtra fizike që ndihmojnë për t'i mbajtur fëmijët të ngrohtë. Në fund, ndryshoni aktivitetet herë pas here për të mbajtur fëmijët të angazhuar dhe të interesuar. Kjo ndihmon në zhvillimin e tyre të plotë dhe i përgatit për të ardhmen.

## Roli i prindërve në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve parashkollorë Kokë më kokë

Bisedat mes jush si prindër dhe fëmijëve ndihmojnë për të mësuar vlera, aftësi komunikimi, dhe informacion të rëndësishëm që ndihmojnë në zhvillimin emocional, gjuhësor, dhe social. Ju mund t'i përdorni këto biseda për të ndihmuar fëmijët të kuptojnë botën rreth tyre dhe të zhvillojnë lidhje më të forta mes tyre. Ja disa tema të rëndësishme për biseda që ju, si prindër, mund të zhvilloni me fëmijët parashkollorë:

- ☆ **Familja dhe anëtarët e saj.** Ju mund të flisni me fëmijët për anëtarët e familjes, për rolin dhe rëndësinë e tyre. Mund të diskutohen emrat, profesionet, aktivitetet e përditshme të prindërve dhe vëllezërve e motrave, dhe mund të bëhen pyetje për ndihmën që fëmijët mund t'u ofrojnë të tjerëve. Këto biseda i ndihmojnë fëmijët të kuptojnë marrëdhëniet e tyre familjare dhe të zhvillojnë një lidhje më të fortë emocionale me anëtarët e tjerë të familjes.
- ☆ **Vlerat dhe ndjenjat.** Biseda për ndjenjat është një mundësi për të mësuar fëmijët të identifikojnë dhe të shprehin emocionet e tyre. Ju mund të flisni me ta për ndjenja si gëzim, trishtim, frikë, dhe inat, duke i ndihmuar fëmijët të kuptojnë se është normale të ndihen kësh tu dhe të mësojnë si të reagojnë në mënyra të shëndetshme.
- ☆ **Të mësuarit për atdheun dhe kulturën afgane**
- ☆ **Ndarja dhe miqësia.** Biseda mund të përfshijë rëndësinë e ndarjes me të tjerët dhe zhvillimin e miqësive të shëndetshme. Ju mund të flisni me ta si të ndajnë lodrat dhe ushqimin me të tjerët, si të kujdesen për miqtë dhe të ndihmojnë ata kur kanë nevojë.
- ☆ **Të mësuarit për respektin dhe sjelljen e mirë.** Si prindër, ju mund të diskutoni me ta sa i rëndësishëm është respekti dhe sjellja e mirë me të tjerët, duke i mësuar fëmijët si të përdorin

fjalët e mirësjelljes (“të lutem” dhe “faleminderit”), si të respektojnë hapësirën dhe kohën e të tjerëve dhe të jenë të kujdesshëm ndaj ndjenjave të tjerëve.

- ☆ **Përgjegjësia dhe ndihma për shtëpinë.** Ju mund të flisni me fëmijët për rëndësinë e ndihmës në punët e shtëpisë, si pastrimi, rregullimi i lodrave dhe ushqimi i kafshëve. Kjo i ndihmon ata të zhvillojnë një ndjenjë të përgjegjësisë dhe të kuptojnë rëndësinë e kontribuimit në shtëpi.
- ☆ **Të mësuarit për shëndetin dhe mirëqenien.** Ju mund të flisni për rëndësinë e një diete të shëndetshme, aktivitetit fizik dhe shëndetit mendor. Mund të diskutoni me ta për rëndësinë e ushqimeve të shëndetshme, si perimet dhe frutat, dhe ndihmën që aktivitetet fizike ofrojnë për trupin.

## Edukimi i vlerave njerëzore

Ju mund të zhvilloni vlerat njerëzore te fëmijët tuaj përmes aktiviteteve të përditshme që inkurajojnë dashurinë, mirësinë, ndihmën dhe respektin për të tjerët. Këto veprimtari mund të përfshijnë lojëra, histori, dhe aktivitete që i ndihmojnë fëmijët të kuptojnë dhe praktikojnë këto vlera, duke kontribuar në formimin e një karakteri të shëndetshëm dhe të dashur.

Veprimtaritë që mund të organizoni me fëmijët për të mësuar dhe zhvilluar vlerat njerëzore, janë të rëndësishme për formimin e karakterit dhe përgatitjen e fëmijëve që të jenë qytetarë të mirë dhe të dashur. Vlerat si respekti, ndihma për të tjerët, ndershmëria, mirësia, dhe bashkëpunimi janë thelbësore për zhvillimin e shëndetshëm emocional dhe social të fëmijëve. Ja disa veprimtari që ju, si prindër, mund të organizoni për të ndihmuar fëmijët të zhvillojnë këto vlera:

- ☆ **Ndihma dhe kujdesi për të tjerët.** Fëmijët mund të mësojnë për ndihmën duke marrë pjesë në aktivitete që përfshijnë ndihmën për të tjerët, si për shembull ndihmesa e prindërve për të pastruar shtëpinë, përgatitja e ushqimit ose kujdesi për kafshët shtëpiake.
- ☆ **Ndershmëria dhe sinqeriteti.** Fëmijët mund të luajnë lojëra me role ku ata mund të imitojnë situata që përfshijnë vendime që kërkojnë ndershmëri, të pranojnë gabimet e bëra dhe të kërkojnë falje.
- ☆ **Respekti ndaj të tjerëve.** Fëmijët mund të mësojnë për respektin për të tjerët dhe për mjedisin duke krijuar një zakon për të përdorur fjalë të sjellshme si “Ju lutem!” dhe “Faleminderit!” dhe duke mësuar të respektojnë hapësirën dhe kufizimet e të tjerëve.

- ☆ **Mirësia dhe ndihma ndaj fëmijëve të tjerë.** Fëmijët mund të mësojnë për mirësinë duke ndihmuar fëmijët më të vegjël ose ata që kanë nevojë.
- ☆ **Miqësia dhe ndarja.** Fëmijët mund të luajnë lojëra ku ata duhet të ndajnë lodra ose ushqime me të tjerët, duke krijuar një mjedis ku ndarjen dhe miqësinë të bëhen pjesë të natyrshme të jetës së tyre.
- ☆ **Përdorimi i përrallave për mësimin e vlerave.** Ju mund t'u tregoni përralla të thjeshta që përmbajnë mësim mbi vlerat si ndihma për të tjerët, të drejtat e të gjithëve, dhe vlerat e ndershmërisë dhe dashurisë për familjen.
- ☆ **Falja.** Fëmijët mund të mësojnë për faljen përmes aktiviteteve ku ata duhet të kërkojnë falje për diçka që kanë bërë gabim, si dhe të falin dikë që ka bërë diçka të keqe.
- ☆ **Dashuria dhe përkujdesja.** Fëmijët mund të mësojnë për dashurinë dhe kujdesin për të tjerët përmes aktiviteteve të thjeshta si përgatitja e një dhurate për dikë tjetër, përkrahja e prindërve në punët e shtëpisë, ose kujdesi për një kafshë shtëpiake.

## Edukimi atdhetar

Për fëmijët afganë që jetojnë jashtë vendit, është shumë e rëndësishme të mbështeten në ndërtimin e një lidhjeje të dashur dhe pozitive me atdheun e tyre përmes aktiviteteve të thjeshta dhe argëtuese. Këto aktivitete janë të thjeshta dhe argëtuese për fëmijët dhe ndihmojnë në ruajtjen dhe forcimin e identitetit kulturor dhe dashurisë për Afganistanin në mënyrë të natyrshme dhe pozitive. Ja disa veprimtari që ju mund të bëni për t'i ndihmuar fëmijët të krijojnë dashuri dhe krenari për vendin tuaj, Afganistanin:

- ☆ **Leximi i tregimeve dhe përrallave afgane.** Përrallat afgane janë të mbushura me mësim dhe vlera kulturore. Ato shpesh përfshijnë karaktere si heronj të historisë afgane, kafshë simbolike dhe figura mitologjike që pasqyrojnë identitetin dhe traditat e popullit afgan. Lexoni tregime të bukura popullore ose përralla të njohura nga kultura afgane. Zgjidhni histori që pasqyrojnë vlerat, traditat, dhe natyrën e Afganistanit. Këto histori i ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë një lidhje emocionale me kulturën e tyre dhe t'u zgjojnë kureshtjen për vendin e origjinës.
- ☆ **Mësimi i këngëve dhe i vjershave popullore afgane.** Këngët dhe vjershat janë një pjesë e rëndësishme e çdo kulture dhe mund të jenë një mundësi e mirë për të mësuar fëmijët për historinë dhe traditat afgane. Fëmijët mund të këndojnë këngë tradicionale afgane, të cilat shpesh

pasqyrojnë dashurinë për natyrën, familjen dhe vendin. Mësoni këngë të thjeshta tradicionale ose vjersha popullore afgane, të cilat fëmijët mund t'i këndojnë dhe t'i kërcënojnë. Këngët janë një mundësi e mirë për të ndërtuar lidhje emocionale me kulturën. Ky aktivitet përforcon njohjen e gjuhës dhe traditave, duke përçuar në mënyrë të gëzueshme kujtime të vendit të origjinës.

- ☆ **Përdorimi i gjuhës afgane.** Një nga aspektet më të rëndësishme të identitetit kulturor është gjuha. Mësimi i gjuhës që përdoret në Afganistan është një mundësi që fëmijët tuaj të ruajnë lidhjen me kulturën dhe trashëgiminë e tyre.
- ☆ **Vizatimi dhe pikturimi i peisazheve të Afganistanit.** Fëmijët mund të mësojnë për peizazhet mahnitëse të Afganistanit. Ju mund t'u tregoni për malet e famshme dhe për bukurinë e natyrës që ndodhet në të gjithë vendin, nga shkretëtirat deri në pyjet e dendura. Mund t'u tregoni pamje të maleve, lumenjve, fushave ose qyteteve afgane dhe t'i ftoni fëmijët të pikturojnë ose vizatojnë ato që shohin. Ky aktivitet ndihmon fëmijët të njohin bukurinë natyrore të Afganistanit dhe të ndiejnë lidhjen me peizazhet e vendit. Gjithashtu, vizatimet e modeluara nga tapetet afgane i ndihmojnë fëmijët të kuptojnë elementet e kulturës së tyre. Kjo mund të përfshijë ngjyrosjen e motiveve tradicionale dhe krijimin e objekteve që përfaqësojnë kulturën afgane.
- ☆ **Ndërtimi i modeleve të monumenteve të njohura.** Me materiale të thjeshta si balta ose letra, ju mund t'i ndihmoni fëmijët të ndërtojnë modele të monumenteve të njohura afgane. Ky aktivitet i ndihmon ata të mësojnë rreth historisë dhe trashëgimisë së Afganistanit, duke përforcuar ndjenjën e krenarisë.
- ☆ **Përgatitja e ushqimeve tradicionale.** Ushqimi është një pjesë e rëndësishme e kulturës afgane. Ju mund të flisni me fëmijët tuaj për gatimin dhe vlerën e ushqimeve tradicionale afgane. Po ashtu mund të përgatisni bashkë me ta ushqime tradicionale afgane. Ushqimi sjell kujtimet e Afganistanit në shtëpi, duke ndërtuar dashuri dhe lidhje përmes aromës dhe shijes së ushqimeve tradicionale.
- ☆ **Lojërat popullore afgane.** Prezantoni lojëra të thjeshta tradicionale afgane. Ky aktivitet u mëson fëmijëve lojërat e njohura të kulturës afgane dhe i ndihmon të kuptojnë si argëtohen dhe shoqërohen fëmijët e moshës së tyre në Afganistan.
- ☆ **Krijimi i flamurit të Afganistanit.** Ndihmohuni fëmijët tuaj të krijojnë flamurin e Afganistanit me letër dhe ngjyra, duke u shpjeguar ngjyrat dhe simbolikën e tij. Ky aktivitet ndihmon në

zhvillimin e dashurisë dhe respektit për vendin, si dhe për vetëdijen mbi identitetin kombëtar.

- ☆ **Tregime rreth jetës së familjes në Afganistan.** Ju mund t'u tregoni fëmijëve historitë dhe përvojat tuaja të fëmijërisë në Afganistan, histori të thjeshta për lojërat që luanit, vendet që vizitonit, dhe njerëzit që takonit. Këto tregime ndihmojnë në ruajtjen e kujtimeve të çmuara dhe përforcojnë ndjenjën e përkatësisë dhe lidhjes me historinë familjare.
- ☆ **Organizimi i "Ditës së Afganistanit" në shtëpi.** Një ditë e dedikuar për Afganistanin mund të përfshijë veshje tradicionale, këngë, histori, dhe ushqime afgane. Familja mund të ftojë edhe miq për të festuar. Kjo i ndihmon fëmijët të ndihen krenarë për kulturën e tyre dhe i jep një ndjesi të fortë përkatësie dhe identiteti.
- ☆ **Fletë pune me figura nga Afganistani.** Fëmijët mund të ngjyrosin fletë me figura të kafshëve, bimëve, dhe peizazheve të Afganistanit për të mësuar më shumë rreth natyrës dhe simboleve të vendit të tyre. Ky aktivitet i ndihmon të zhvillojnë njohuritë rreth bukurive të vendit të tyre dhe të mësojnë të vlerësojnë trashëgiminë natyrore.
- ☆ **Ritualet dhe festat tradicionale.** Prindërit mund të flasin me fëmijët për traditat, historinë, festat dhe simbolet e kulturës afgane. Mund të diskutohen shenjave të rëndësishme të kulturës dhe rëndësia e ruajtjes së traditave. Festoni festa tradicionale duke ndjekur disa nga traditat e Afganistanit, si përgatitja e ushqimeve tipike ose dekorimi i shtëpisë. Ky aktivitet u mëson fëmijëve për festat dhe traditat, duke i ndihmuar të ndihen të lidhur me kulturën e tyre edhe në një mjedis të ri.
- ☆ **Biseda për njerëz të njohur afganë.** Ju mund t'u tregoni histori për njerëz të famshëm ose të suksesshëm nga Afganistani, si artistë, sportistë ose figura historike. Këto tregime mund t'i frymëzojnë fëmijët dhe t'i ndihmojnë të ndihen krenarë për arritjet e vendit të tyre dhe të aspirojnë për të bërë gjëra të mëdha.
- ☆ **Lojëra me veshje tradicionale.** Lojërat tradicionale afgane ndihmojnë fëmijët të lidhen me kulturën e tyre në një mënyrë të natyrshme dhe të gëzueshme. Aktivitetet e tilla si lojërat me top, gara dhe lojërat në grup janë pjesë e rëndësishme e zhvillimit kulturor dhe social të fëmijëve. Gjithashtu, mund të krijoni një "lojë me kostume" ku fëmijët veshin rroba tradicionale afgane, dhe prindërit mund të shpjegojnë kuptimin e tyre. Kjo i ndihmon fëmijët të njohin dhe të duan veshjet e kulturës së tyre dhe t'i respektojnë traditat.

## Veprimtari praktike për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve

Për fëmijët afganë që jetojnë në një mjedis ku flitet një gjuhë tjetër, zhvillimi i gjuhës është thelbësor për t'i ndihmuar të komunikojnë dhe të përshtaten me rrethin e tyre. Në vijim jepen disa aktivitete që prindërit mund të bëjnë së bashku me fëmijët për të përmirësuar aftësitë gjuhësore në të dyja gjuhët.

- ☆ **Leximi i librave me figura në të dyja gjuhët.** Leximi i librave të thjeshtë me figura në të dy gjuhët ndihmon në zhvillimin e fjalorit. Fëmijët mund të mësojnë të identifikojnë objektet, ngjyrat dhe format, gjë që i ndihmon të zhvillojnë një fjalor të pasur.
- ☆ **Lojëra me fjalë dhe kartela të ilustruara.** Përdorni kartat me figura (si kafshë, objekte shtëpiake, ushqime) dhe luani lojëra ku fëmijët identifikojnë fjalët në të dyja gjuhët. Për shembull, tregojuni një kartë dhe kërkoni nga fëmija të thotë emrin e figurës në gjuhën afgane dhe shqipe. Kjo metodë e thjeshtë ndihmon fëmijën të kuptojë se çdo objekt ka një emër të ri në secilën gjuhë dhe forcon lidhjet midis fjalëve dhe objekteve.
- ☆ **Vjersha dhe poezi të thjeshta.** Recitimi i rimave dhe poezive të thjeshta ndihmon fëmijët të mësojnë ritmin e gjuhës dhe t'i familjarizojë me tingujt e rinj. Ju mund t'i inkurajoni fëmijët të mësojnë rimat në gjuhën e re dhe të krijojnë një rutinë ditore me to, si p.sh., të recitojnë rima gjatë larjes së duarve ose para gjumit.
- ☆ **Lojëra me emra të përditshëm.** Në përditshmëri, ju mund të emërtoni objekte që fëmija përdor çdo ditë. Për shembull, gjatë drekës, ata mund të thonë emrin e ushqimeve në të dyja gjuhët.
- ☆ **Vizatimi dhe diskutimi për çdo vizatim.** Vizatimi është një mjet i fuqishëm për të inkurajuar të folurën. Kërkoni nga fëmija të vizatojë diçka që i pëlqen dhe më pas ta përshkruajë atë. Përdorni pyetje të thjeshta si "Çfarë është kjo?" ose "Çfarë po bën kjo kafshë?" për ta nxitur fëmijën të flasë.
- ☆ **Lojëra të thjeshta "Kush jam unë?"** për emërtimin e fjalëve. Luani lojën "Kush jam unë?" duke përshkruar një objekt apo kafshë pa e treguar dhe kërkoni nga fëmija t'i gjejë emrin. Për shembull, "Unë jam i gjatë, kam degë të forta dhe gjethe të gjelbra. Kush jam unë?" (Pema).
- ☆ **Shëtitje dhe biseda.** Gjatë shëtitjeve, ju mund t'i përshkruani fëmijës gjërat që shohin duke përdorur të dyja gjuhët, si për shembull "Shiko, kjo është një lule. Në gjuhën tjetër quhet ...."
- ☆ **Përgjigje në dy gjuhë.** Fëmijët shpesh bëjnë pyetje për botën rreth tyre. Ju mund t'u përgjigjeni këtyre pyetjeve në të dyja gjuhët, për të forcuar fjalorin dhe për t'i ndihmuar ata të kuptojnë



se çdo gjë mund të emërtohet në disa mënyra. Kjo metodë ndihmon fëmijën të kuptojë dhe të praktikojë fjalët që i mëson, dhe e ndihmon të jetë më i sigurt në përdorimin e tyre.

- ☆ **Lojë në role.** Prindërit mund të krijojnë tregime të vogla me kafshë ose lodra dhe të ndërrojnë role së bashku me fëmijën, duke përdorur fjalë dhe fraza të thjeshta. Për shembull, një kukull mund të thotë “Unë dua të dal shëtitje” dhe fëmija mund të përgjigjet: “Po. Le të shkojmë në park”. Lojërat me role ndihmojnë në zhvillimin e dialogut dhe në përmirësimin e aftësive të komunikimit në një mënyrë të natyrshme.
- ☆ **Gatimi i ushqimeve.** Gjatë gatimit, ju mund të përshkruani çdo hap të procesit dhe të përmendni emrat e ushqimeve dhe të veglave në të dyja gjuhët. Për shembull, “Ky është një tas me fruta. Do t’i presim dhe me to do të përgatisim një sallatë frutash”. Gatimi është një aktivitet argëtues dhe shumë praktik, dhe i ndihmon fëmijët të lidhen me fjalët përmes përvojave të përditshme.

## Me librin pranë

Leximi i librave me fëmijët parashkollorë është një aktivitet i rëndësishëm për zhvillimin e tyre intelektual, emocional dhe social. Ky aktivitet jo vetëm që ndihmon në përgatitjen e fëmijëve për shkollë, por gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive komunikative.

- ☆ **Zhvillimi i aftësive gjuhësore.** Leximi i librave ndihmon fëmijët të pasurojnë fjalorin e tyre dhe të zhvillojnë aftësinë për të kuptuar dhe përdorur fjalët në kontekste të ndryshme.
- ☆ **Zhvillimi i aftësive të dëgjimit dhe përqendrimit.** Kur një fëmijë dëgjon një histori, ai mëson të përqendrohet, të dëgjojë me vëmendje dhe të mbajë mend detaje të ndryshme të ngjarjeve. Ky proces përmirëson aftësinë e tij për të ndjekur udhëzime dhe për të kuptuar informacionin që i prezantohet.
- ☆ **Zhvillimi i imagjinatës dhe kreativitetit.** Librat me figura dhe histori të ndryshme stimulojnë imagjinatën e fëmijëve, duke i inkurajuar të mendojnë për mundësi të pafundme dhe të krijojnë skenarë dhe histori në mendjen e tyre. Ky aktivitet ndihmon në zhvillimin e kreativitetit dhe mendjes kritike.
- ☆ **Fuqizimi i lidhjeve emocionale dhe sociale.** Leximi i librave është një mundësi për prindërit dhe fëmijët të kalojnë kohë cilësore së bashku dhe të krijojnë një lidhje emocionale të fortë.

Fëmijët mund të identifikohen me personazhet në libra, duke ndihmuar ata të kuptojnë dhe të përpunojnë ndjenjat e tyre.

- ☆ **Zhvillimi i aftësive për zgjidhjen e problemeve.** Historia që zhvillohet në një libër shpesh ka situata që kërkojnë zgjidhje ose marrjen e vendimeve. Fëmijët mund të mësojnë si të mendojnë dhe të reflektojnë mbi situata të ndryshme, si dhe të bëjnë pyetje për to.
- ☆ **Lexoni libra të thjeshtë dhe diskutoni historinë,** duke bërë pyetje si “Çfarë mendon se do të ndodhë më tej?” ose “Çfarë do të bëje ti në këtë situatë?”. Diskutimi ndihmon fëmijët të kuptojnë dhe analizojnë historinë, duke zhvilluar të menduarit kritik dhe aftësitë e kuptimit.

## Përrallat dhe historitë për fëmijët në moshën parashkollorë

Përrallat dhe historitë janë një mjet i shkëlqyer për të zhvilluar të folurin e fëmijëve parashkollorë. Këto tregime ndihmojnë në zgjerimin e fjalorit, në përmirësimin e aftësive të të dëgjuarit, dhe në nxitjen e aftësisë së tyre për të shprehur mendimet dhe ndjenjat. Ndër historitë më të dashura për fëmijët e kësaj moshe janë:

**Histori me kafshë dhe personazhe të njohur.** Për shembull, një histori për një arushë të vogël që kërkon të gjejë mjaltë, ndërsa takon kafshë të tjera gjatë rrugës. Ky lloj tregimi e ndihmon fëmijën të njohë emrat e kafshëve dhe të përshkruajë sjelljet e tyre. Ndërveprimet e ndryshme të personazheve e inkurajojnë fëmijën të përdorë fjalë dhe fraza të reja.

**Histori me rimë dhe përsëritje.** Historia klasike “Tre Derrkucët” është një shembull i mirë, sepse ka shumë fjalë që përsëriten. Përsëritja ndihmon fëmijët të mësojnë dhe kuptojnë fjalët më shpejt. Rimat dhe tingujt e ngjashëm gjithashtu i ndihmojnë fëmijët të ndjekin ritmin dhe t’i imitojnë lehtësisht.

**Përralla dhe mite popullore.** Këto tregime u mësojnë fëmijëve për traditat dhe kulturën, ndërsa përfshijnë tema morale dhe mësimi jete. Përrallat si “Dhelpra dhe rrushtë” ose “Lepuri dhe Breshka” janë të thjeshta, me fraza të shkurtëra që e inkurajojnë fëmijën të imitojë dhe të tregojë pjesë nga historia.

**Histori me role të përmbysura.** Tregimet ku personazhet veprojnë në mënyrë të pazakontë (si një lepur që është shumë i guximshëm) nxisin fëmijët të bëjnë pyetje dhe të shprehin mendime për zgjedhjet e personazheve. Kjo i ndihmon ata të mendojnë jashtë kornizës dhe të përdorin fjalë për të përshkruar gjërat që u duken të çuditshme.

**Histori për jetën e përditshme dhe emocionet.** Histori për ndodhi të përditshme si një ditë në bregdet,

një udhëtim me autobus ose një piknik në mal i mëson fëmijët fjalët që lidhen me aktivitete të përditshme. Përfshirja e emocioneve (gëzim, frikë, trishtim) i ndihmon të shprehin ndjenjat dhe të mësojnë fjalë të reja që lidhen me emocionet.

**Histori që nxisin pyetjet.** Ato janë një mënyrë shumë efektive për të zhvilluar mendimin kritik dhe të folurin e fëmijëve parashkollorë. Kur historitë janë intriguese dhe me detaje të pazakonta, ato i bëjnë fëmijët të ndihen kureshtarë, duke i shtyrë të pyesin për të kuptuar më shumë.

**Histori që nxisin kryerjen e eksperimenteve dhe nxjerrjen e përfundimeve të thjeshta.** Këto histori i ndihmojnë fëmijët të eksplorojnë botën përmes të kuptuarit praktik dhe eksperimentimit. Këto tregime i bëjnë ata të mendojnë, të vëzhgojnë dhe të testojnë idetë e tyre, duke nxjerrë përfundime të thjeshta.

**Histori që nxisin fëmijët të krijojnë historitë e tyre.** Këto histori i ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e imagjinatës dhe të shprehjes së lirë. Kur historitë janë të hapura, plot me aventura dhe personazhe të këndshëm, ato inkurajojnë fëmijët të shtojnë ide të reja dhe të krijojnë rrëfime të tyre.

**Histori që përfshijnë situata problemore nga jeta e përditshme** janë një mjet i fuqishëm për t'i ndihmuar fëmijët të zhvillojnë aftësitë e tyre për të zgjidhur probleme dhe për të marrë vendime. Këto tregime i nxisin fëmijët të mendojnë në mënyrë logjike dhe të gjejnë zgjidhje për situata të zakonshme që mund të hasin.

**Histori që i ndihmojnë fëmijët të krijojnë dhe të qepin veshje për personazhet e tyre të dashur** mund të jenë të mbushura me aventura dhe kreativitet. Këto tregime i inkurajojnë fëmijët të mendojnë për dizajnin, ngjyrat dhe materialet dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre praktike për qepje.

**Histori që i nxisin fëmijët të vizatojnë** mund të përfshijnë aventura të këndshme, personazhe të dashur dhe tema që fëmijët mund t'i shohin qartë në mendjen e tyre dhe të duan t'i sjellin në letër përmes vizatimit. Këto histori inkurajojnë fëmijët të shprehin idetë e tyre vizualisht dhe të eksplorojnë ngjyra, forma dhe detaje të ndryshme.

**Histori të thjeshta dhe imagjinate.** Ato i nxisin fëmijët parashkollorë të duke i ndihmuar për zhvillimin e kreativitetit të tyre. Këto tregime duhet të përmbajnë detaje interesante dhe personazhe të larmishëm që fëmijët të frymëzohen të krijojnë vizatime të gjalla.

**Histori që ndihmojnë fëmijët të përshtaten në kushtet e reja** ku janë zhvendosur janë shumë të dobishme për të ndihmuar fëmijët të ndihen të sigurt dhe të pranuar në ambientin e ri. Këto tregime mund të përfshijnë personazhe që përballen me sfida të ngjashme dhe që mësojnë të ndërtojnë miqësi, të pranojnë ndryshimet, si dhe të ruajnë identitetin e tyre kulturor.

## Zhvillimi i imagjinatës

Histori që nxisin imagjinatën e fëmijëve parashkollorë janë ato që janë të pasura me elemente fantastike, personazhe të veçantë dhe ngjarje që e ftojnë fëmijën të mendojë jashtë kufijve të realitetit. Këto histori shpesh përmbajnë elemente të natyrës, të magjisë dhe aventura, duke u dhënë mundësinë fëmijëve të krijojnë botë të reja në imagjinatën e tyre dhe të eksplorojnë mundësi të pafundme.

Historitë me elemente fantastike janë të gjitha të ndërtuara për të stimuluar imagjinatën dhe krijimtarinë e fëmijëve parashkollorë. Ato i lejojnë ata të shikojnë botën në një mënyrë më të gjerë dhe të mendojnë për mundësi të pafundme, duke i ndihmuar të zhvillojnë aftësitë e tyre për të menduar, krijuar dhe eksploruar.

## Zhvillimi i të menduarit të fëmijëve

Histori që zhvillojnë të menduarit e fëmijëve janë ato që nxisin reflektim, kërkim të zgjidhjeve, analizë të situatave dhe vendimmarrje. Këto tregime shpesh përfshijnë situata që kërkojnë mendim kritik, zgjidhje të problemeve dhe zhvillim të aftësive të larta të të menduarit. Këto Përrallat afgane janë të pasura me tregime plot mësim dhe vlera, të përshtatshme për fëmijët parashkollorë. Shumë prej tyre përmbajnë personazhe kafshësh dhe tema që përçojnë mesazhe të thjeshta për dashurinë, miqësinë, ndershmërinë dhe kurajon.

Në mënyrë të përmbledhur, ju mund të gjeni përrallat më të njohura afgane, të cilat mund t'ua tregoni fëmijëve tuaj. Këto tregime të thjeshta, plot mençuri dhe simbolikë, ndihmojnë fëmijët parashkollorë të mësojnë vlera të rëndësishme ndërsa argëtohen

**“Miu dhe deveja”.** Përralla i mëson fëmijët për kufijtë e tyre dhe rëndësinë e përlësisë.

*Kënaqësi fizike.* Aktiviteti përfshin lëvizje dhe kërcime, gjë që ndihmon në argëtimin dhe energjizimin e tyre.

**Këshilla për prindërit**

Lejojini fëmijët të shtojnë lëvizje të tyre, si për shembull duke përfytyruar se janë lule me ngjyra të ndryshme ose kafshë të ndryshme.

Për fëmijët më të vegjël, mund të zvogëloni lëvizjet ose ritmin, ndërsa për fëmijët më të mëdhenj mund të shtoni më shumë variacione dhe sfida.

**LOJA Nr. 16** Notim në oqean**Kohëzgjatja: 5-10 minuta****Përshkrimi i lojës**

Kjo lojë është një aktivitet argëtues dhe fizik që ndihmon fëmijët të përqendrohen dhe të bashkëpunojnë, duke stimuluar imagjinatën dhe lëvizjet e tyre. Gjatë lojës, fëmijët do të imitojnë lëvizjet e peshqve në oqean, duke mësuar të koordinohen dhe të ndjekin udhëzime.

**Materialet e nevojshme**

Litar ose shkumës.

**Si të luani?**

Përdorni litarin ose shkumësin për të vizatuar tre rrethe në dysHEME. Këto rrethe do të jenë “shtëpitë” ku peshqit do të kthehen pas çdo “stuhie.”

Tregojuni fëmijëve se ata janë peshq të vegjël që notojnë në oqean. Ndajini ata në tre grupe dhe caktojuni secilit grup nga një “shtëpi peshku.”

Tregojuni fëmijëve të fillojnë të “notonin” në fushën e lojës. Ata mund të lëvizin lirshëm, por me kujdes që të mos përplasnin “bishtat” (duhet të shmangin prekjen me shokët).

Udhëzojini të ndryshojnë shpejtësinë ose mënyrën e lëvizjes, për shembull: “Notoni ngadalë”, “Notoni shpejt”, “Notoni në rrathë.” Sa herë që ju shpallni “Stuhi!”, fëmijët duhet të notojnë sa më shpejt në shtëpinë e tyre.

**Variacione të lojës**

Si një variant, në vend të peshqve, fëmijët mund të imagjinojnë se janë zogj të vegjël që fluturojnë përreth, duke u përpjekur të mos përplasnin “krahët” me shokët.

Për të bërë lojën më interesante, kërkojuni fëmijëve të lëvizin në mënyra të ndryshme, si duke kërcyer ose duke ecur me majat e gishtave.

**Çfarë mësojnë fëmijët?**

Koordinimi dhe kontrolli i lëvizjeve. Fëmijët zhvillojnë aftësitë e tyre motorike, duke praktikuar lëvizje të kujdesshme dhe të kontrolluara.

Përqendrimi dhe vëmendja. Ata mësojnë të ndjekin udhëzimet dhe të përqendrohen për të shmangur prekjen me shokët e tyre. Kreativiteti. Kjo lojë stimuluese ndihmon në zhvillimin e imagjinatës dhe aftësive sociale të fëmijëve.

**Këshilla për prindërit**

Për fëmijët më të vegjël, ulni intensitetin e lëvizjeve ose përdorni variacione më të thjeshta, ndërsa për fëmijët më të mëdhenj, shtoni më shumë sfida si lëvizje më të vështira ose më shumë rregulla.

Lejojini fëmijë të propozojnë kafshë të tjera për lojë dhe inkurajoni ata të shpikin lëvizje të reja.

**LOJA Nr. 17** Prek dhe zbulo**Kohëzgjatja: 10-15 minuta****Qëllimi i lojës**

Kjo lojë ndihmon fëmijët të zhvillojnë ndjeshmërinë dhe aftësinë për të përshkruar objektet duke përdorur shqisat e tyre. Ata do të mësojnë të njohin forma, madhësi, tekstura dhe të zhvillojnë aftësi të njohjes dhe përshkrimit, duke forcuar njohuritë e tyre mbi konceptet bazë të objekteve.

**Materialet që ju nevojiten**

Objekte të ndryshme si top, pjatë, portokall, gjethe, fasule, lugë ose filxhan.

Një copë pëlhurë që mjafton për të mbuluar objektet.

**Si ta luani lojën?**

Mbuloni objektet e zgjedhura me një copë pëlhurë në mënyrë që fëmijët të mos mund t'i shohin.

Lëri fëmijët të prekin objektet nën pëlhurë dhe të përshkruajnë se si ndihen ato. Pyetini se si është sipërfaqja e objektit (e butë, e ashpër, e lëmuar), forma (e rrumbullakët, e katrorë), madhësia (e madhe, e vogël), pesha (e rëndë, e lehtë), etj.

Pasi ta përshkruajnë objektin, kërkojuni të gjejnë se çfarë objekti është duke u bazuar vetëm te përshkrimi dhe ndjesia e prekur.

**Këshilla**

Nëse fëmijët kanë vështirësi për të gjetur objektin, mund t'ua tregoni fillimisht objektet, pastaj t'i mbuloni me pëlhurë dhe t'i kërkonin të gjejnë objektet sipas përshkrimeve të tyre.

Ndihmojini të përshkruajnë karakteristikat e objekteve në mënyrë sa më të thjeshtë dhe të qartë.

**Variacione të lojës**

Zgjidhni objekte që kanë forma, madhësi ose tekstura të ndryshme (p.sh., portokall dhe gurë të vegjël) dhe kërkojuni fëmijëve të përshkruajnë dallimet midis tyre.

Vendosni disa objekte nën pëlhurë dhe kërkojuni fëmijëve t'i prekin dhe t'i numërojnë, duke përdorur vetëm ndjesinë e prekurit për të kuptuar se sa janë.

**Çfarë mësojnë fëmijët?**

*Zhvillimi i perceptimit të ndjesive.* Fëmijët mësojnë të dallojnë karakteristikat e objekteve si madhësia, forma dhe tekstura.

*Praktikimi i përshkrimit.* Ata zhvillojnë aftësinë e të folurit dhe përshkrimit të objekteve duke u bazuar në ndjesitë e tyre.

*Njohuritë mbi konceptet bazë.* Fëmijët mësojnë dhe kuptojnë më mirë konceptet bazë që lidhen me karakteristikat fizike të objekteve, duke i ndihmuar në mësimet e mëvonshme.

**LOJA Nr. 18****Gjej shokun****Kohëzgjatja: 5-10 minuta****Qëllimi i lojës**

Kjo lojë ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësitë sociale, të krijojnë marrëdhënie dhe të mësojnë të bashkëpunojnë me të tjerët. Ata mësojnë të punojnë në grupe dhe të përgjigjen ndaj sinjaleve me shpejtësi.

**Materialet që ju nevojiten**

Nuk kërkohet asnjë material.

**Si ta luani lojën?**

Lëri fëmijët të lëvizin lirshëm në zonën e lojës. Ata mund të ecin, kërcasin, ose bëjnë lëvizje të tjera në varësi të sinjalit tuaj (p.sh. një duartrokkitje ose fishkëllimë).

Kur të jepni sinjalin, kërkojini fëmijëve të gjejnë një shok dhe të formojnë grupe me nga dy persona. Pasi të formojnë çifte, ata ndahen dhe lëvizin përsëri të lirë.

Pasi ta kenë zotëruar krijimin e çifteve, kërkojuni të formojnë grupe më të mëdha, p.sh., me nga tre ose katër persona. Kjo ndihmon në përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe bashkëpunimit.

**Variacione**

Në vend që të ecin lirshëm, kërkojuni të ecin mbrapsht ose të kërcëjnë ndërsa lëvizin nëpër zonën e lojës. Kjo rrit argëtimin dhe sfidën e lojës.

**LOJA Nr. 19****Mbledhja e thesareve****Kohëzgjatja: 10-15 minuta****Materialet që ju nevojiten**

Nuk kërkohet asnjë material.

**Si ta luani lojën?**

Kjo lojë zhvillohet jashtë. Kërkojini fëmijëve të gjejnë dhe mbledhin dy shembuj të një objekti të caktuar (p.sh., dy gurë, gjethe, ose shkopinj) dhe t'i sjellin te ju.

Pasi t'i mbledhin objektet, kërkojini fëmijëve t'i tregojnë shokëve të tyre çfarë kanë mbledhur dhe t'i përshkruajnë karakteristikat e këtyre objekteve, si madhësia, forma, ngjyra, ose pesha.

**Këshilla**

Nëse loja është shumë e vështirë për fëmijët më të vegjël, fëmijët më të mëdhenj mund të ndihmojnë të vegjëlit gjatë procesit të mbledhjes dhe përshkrimit.

**LOJA Nr. 20****Krijo botën tënde****Kohëzgjatja: 10-15 minuta****Qëllimi i lojës**

Në këtë lojë, fëmijët do të kenë mundësinë të eksplorojnë dhe krijojnë botën e tyre përmes lojës së lirë, duke

zhvilluar imagjinatën, kreativitetin dhe aftësitë sociale. Kjo lojë ndihmon gjithashtu në përballimin e sfidave emocionale dhe zhvillimin e aftësive për të punuar në grup.

### **Materialet që ju nevojiten**

Nuk kërkohet asnjë material specifik, por mund të përdoren lodra, objekte të shtëpisë, rroba për lojëra me role ose çdo gjë tjetër që fëmijët mund të kenë pranë tyre.

### **Si ta luani lojën?**

Pyetini fëmijët çfarë duan të luajnë sot. A mund të jetë një udhëtim në një vend të ri, një aventurë me superheronj, ose një histori për një familje imagjinare?

Fëmijët mund të vendosin vetë për rolet që duan të marrin, si një udhëheqës, një hero, një prind ose një kafshë.

Lërimi të vishen si personazhe ose të përdorin objekte rreth tyre për të ndihmuar në zhvillimin e historisë.

Ndihmohini fëmijët të zhvillojnë një skenar të thjeshtë duke pyetur “Çfarë ndodh më pas?” dhe duke i nxitur ata të imagjinojnë veprime dhe situata të reja.

Për shembull, ata mund të jenë duke ndërtuar një shtëpi për një mik imagjinar ose duke shpëtuar një qytet nga një rrezik i madh.

Nxitni fëmijët të punojnë së bashku duke ndarë role dhe duke mësuar të negociojnë mes tyre për të vazhduar historinë në mënyrë të suksesshme.

### **Variacione të lojës**

Mund të zgjidhni tema të ndryshme çdo ditë si “Në Hënë”, “Në një ishull të humbur”, ose “Në qytetin e dinosaurëve”.

Inkurajoni fëmijët të krijojnë një skenë të vogël ku ata të performojnë një histori të shkurtër për shokët e tyre, duke përdorur zërat dhe lëvizjet për të shprehur emocionet e personazheve.

Fëmijët mund të krijojnë një shok imagjinar dhe të zhvillojnë lojëra rreth tij, duke e përfshirë atë në aventurat e tyre të përditshme.

### **Këshilla për prindërit**

Lojërat e tilla janë thelbësore për zhvillimin e aftësive sociale dhe njohëse të fëmijëve. Përfshini veten tuaj në lojë kur është e nevojshme për të ndihmuar, por gjithashtu lërimi të marrin iniciativën vetë.

Jepuni fëmijëve hapësirë për të krijuar botën e tyre, por gjithmonë sigurohuni që loja të jetë e sigurt dhe e përshtatshme për moshën.

### **Përfitimet nga loja**

Zhvillimi i kreativitetit dhe imagjinatës.

Ndihmon në përballimin e emocioneve të vështira përmes lojës.

Mësimi i bashkëpunimit dhe zgjidhjes së konflikteve me shokët.

Zhvillimi i këmbënguljes dhe përqendrimit për të përfunduar një aktivitet.

## **LOJA Nr. 21**

## **Koha për zbulim**

### **Kohëzgjatja: 10-15 minuta**

### **Përshkrimi i lojës**

“Koha për Zbulim!” është një aktivitet ku fëmijët janë të lirë të eksplorojnë mjedisin e tyre dhe objektet që kanë në dispozicion. Ata zgjedhin vetë se çfarë duan të luajnë, ndërsa ju siguron një mjedis të sigurt dhe mbështetës për lojën e tyre. Loja e lirë ndihmon në zhvillimin e kreativitetit, pavarësisë dhe vetëbesimit, ndërkohë që u jep mundësinë të mësojnë dhe të zgjidhin problemet në mënyrë autonome.

### **Materialet që mund të përdoren**

Lodra dhe objekte të ndryshme si blloqe ndërtimi, puzzle, topa, kukulla, rroba për veshje, etj.

Materiale natyrore si gjethe, gurë, dhe degëza për t'i përdorur në lojëra imagjinative.

Objekte nga shtëpia: lodra të përditshme që gjenden në shtëpi si filxhanë plastikë, kuti, ose kapakë shishesh.

### **Si ta organizoni lojën?**

Vendosni në dispozicion objekte të ndryshme për fëmijët. Mund të jenë lodra të zakonshme ose materiale të përditshme, si dhe kostume për lojëra me role.

Lejoni që fëmijët të zgjedhin vetë se çfarë duan të bëjnë me objektet. Ata mund të ndërtojnë, të improvizojnë histori, ose të eksplorojnë materialet e reja.

Ndërsa fëmijët luajnë, roli juaj është të jeni një vëzhgues që mban një sy për sigurinë, por pa ndërhyrë në mënyrën se si ata organizojnë lojën. Vetëm ndërhyri nëse ata kanë nevojë për ndihmë ose ka ndonjë rrezik.

Nxitni fëmijët të luajnë së bashku, duke ndarë lodrat dhe ide për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive sociale.

### **Variacione të lojës**

Ftoni fëmijët të luajnë me objekte të lidhura me profesionet e prindërve, për shembull, fëmijët mund të përdorin objekte si vegla pune ose aksesore për të shtirur sikur janë mjekë, zdruckhtarë, ose kuzhinierë.

Fëmijët mund të mbledhin gjethe, gurë ose degëza jashtë dhe të ndërtojnë struktura ose të shpikin histori rreth tyre.

Ndani lojërat në “këndet e zbulimit”, ku secili kënd ka një temë të veçantë si ndërtimi, gatimi, ose krijimi i historive. Fëmijët mund të kalojnë nga një kënd në tjetrin për të eksploruar materiale të ndryshme.



### Këshilla për prindërit

Ruani interesin e fëmijëve duke shtuar lodra të reja ose ndryshuar organizimin e materialeve të lojës.

Mos u përpiqni të drejtoni lojën e fëmijëve, por mbështetni iniciativat e tyre dhe nxisni kreativitetin e tyre.

### Përfitimet nga loja

Zhvillimi i imagjinatës dhe kreativitetit.

Mësimi i bashkëpunimit dhe ndarjes së ideve me bashkëmohatarët.

Përmirësimi i aftësive motorike dhe njohëse përmes zbulimit të materialeve të ndryshme.

## LOJA Nr. 22 Këndet e zbulimit

### Kohëzgjatja: 15-20 minuta

#### Përshkrimi i lojës

“Këndet e Zbulimit” është një aktivitet ku fëmijët janë të lirë të eksplorojnë materiale dhe lodra të organizuara në zona të ndryshme me tema mësimore. Ky aktivitet ndihmon fëmijët të zhvillojnë njohuritë e tyre në fusha të ndryshme si gjuha, matematika, shkenca, kreativiteti dhe ndërtimi. Fëmijët përfitojnë nga të mësuarit përmes lojës së lirë dhe ndërveprimit me objekte të ndryshme.

#### Materialet që mund të përdoren

**Këndi i gjuhës:** Libra me figura, kartolina me shkronja, libra alfabeti, ose lodra që nxisin fjalë dhe tinguj.

**Këndi i matematikës:** Objekte që ndihmojnë në numërim dhe krahasim, si gurë të vegjël, shkopinj, kapakë shishesh, puzzle, ose gota matëse për të krahasuar madhësinë.

**Këndi i zbulimit shkencor:** Ujë, objekte që notojnë ose fundosen, fasule, gjethë dhe lënde të tjera për eksperimentim.

**Këndi i artit:** Lapsa, fletë letre, bojra, copa gazetash për të vizatuar ose krijuar projekte artistike.

**Këndi i lojërave me role:** Kukulla, lodra me role, kostume për të luajtur personazhe të ndryshme si mjekë, kuzhinierë apo shitës.

**Këndi i ndërtimit:** Blloqe druri, argjilë, tulla ose enë kartoni për të ndërtuar struktura të ndryshme.

#### Si ta organizoni lojën?

Vendosni çdo kategori materialesh në zona të veçanta të mjedisit ku fëmijët mund të luajnë. Organizoni materialet në mënyrë që fëmijët të kenë akses të lehtë dhe të jenë të motivuar të zbulojnë.

Fëmijët janë të lirë të zgjedhin se në cilin kënd të luajnë. Lejojini të lëvizin nga një kënd në tjetrin në varësi të interesit të tyre.

Inkurajoni fëmijët të eksplorojnë dhe të ndërveprojnë me objektet dhe lodrat në çdo kënd. Ju mund t’i drejtoni me pyetje për të nxitur mendimin dhe krijimtarinë.

### Variacione të lojës

Ndërroni lodrat dhe materialet në çdo kënd çdo javë për të mbajtur interesin e fëmijëve të gjallë.

Krijoni një kënd të dedikuar për natyrën duke përdorur objekte të mbledhura nga jashtë si gjethë, gurë dhe degëza. Për të inkurajuar bashkëpunimin, krijoni aktivitete që përfshijnë dy ose më shumë fëmijë, për shembull ndërtimi i një strukture së bashku ose krijimi i një historie duke përdorur lodrat e lojërave me role.

### Këshilla për prindërit

Lejojini fëmijët të luajnë lirshëm dhe të marrin iniciativë. Vëzhgoni se çfarë i tërheq më shumë dhe ndihmoni në përforcimin e aftësive të tyre.

Inkurajoni fëmijët të ndajnë lodrat dhe të punojnë së bashku për projekte të përbashkëta në këndet e lojës.

### Përfitimet nga loja

Zhvillimi i aftësive njohëse, motorike dhe sociale.

Nxitja e krijimtarisë dhe mendimit kritik.

Përmirësimi i aftësive për bashkëpunim dhe ndarjen e ideve.

## LOJA Nr. 23 Ndhmo gjarprin të gjejë miq

### Qëllimi i lojës

Kjo lojë ndihmon fëmijët të zhvillojnë kreativitetin dhe aftësitë motorike fine përmes krijimit të zinxhirëve prej letre. Fëmijët mësojnë të punojnë në grup, të përdorin koordinimin sy-dorë dhe të dallojnë ngjyrat dhe format. Kjo lojë, gjithashtu, nxit bashkëpunimin dhe inkurajon krijimtarinë përmes një skenari të këndshëm.

### Kohëzgjatja: 10-15 minuta

#### Çfarë ju nevojitet?

Letra me ngjyra/ Ngjitës/ Shënues

#### Si ta zhvillon lojën

Prisni fletë letre në shirita të hollë për fëmijët. Për fëmijët më të mëdhenj, mund t’i përfshini ata në procesin e prerjes duke i mbikëqyrur për siguri.

Ndani fëmijët në grupe të vogla, duke përfshirë fëmijë të vegjël dhe më të rritur për të inkurajuar ndihmën dhe bashkëpunimin.

Prezantoni një histori të shkurtër për një gjarpër të vetmuar që kërkon miq të rinj. Tregojuni fëmijëve gjarpërin

prej letre që keni krijuar paraprakisht dhe kërkojuni të ndihmojnë në krijimin e miqve të tij duke bërë zinxhirë prej letre.

### **Procesi i krijimit**

Merrni një shirit letre, bëni një unazë dhe ngjitni skajet.

Merrni një tjetër shirit letre, kalojeni përmes unazës së parë dhe ngjitni skajet.

Vazhdojeni këtë proces derisa të krijoni një zinxhir të gjatë, i cili do të përfaqësojë “gjarprin” ose “miqtë e tij të rinj.”

Në vend të gjarprit, mund të krijoni “krimba” ose kafshë të tjera duke përdorur zinxhirë letre, duke u argëtuar dhe eksperimentuar me ngjyra dhe forma.

### **Variacionet e lojës**

Pasi të përfundojnë krijimin e zinxhirëve, fëmijët mund t'i përdorin ato për të dekoruar hapësirën e lojës ose klasën, duke shtuar një ndjesi festive.

Mund ta ktheni këtë aktivitet në një garë miqësore duke i ndarë fëmijët në dy grupe dhe duke parë kush krijon më shumë unaza në një kohë të caktuar.

### **Këshilla për prindërit**

Nëse fëmijët më të vegjël e kanë të vështirë të lidhin unazat, le t'i krijojnë unazat individuale, dhe prindërit ose fëmijët më të rritur t'i ndihmojnë duke lidhur unazat së bashku në një zinxhir.

Lejojini fëmijë të dekorojnë secilin shirit letre me shënues para se ta bëjnë unazë. Kjo rrit kreativitetin dhe bën që çdo gjarpër të jetë unik.

### **Përfitimet nga loja**

Zhvillimi i aftësive motorike fine.

Nxitja e kreativitetit dhe imagjinatës.

Mësimi i bashkëpunimit dhe punës në grup.

Përmirësimi i ndjenjës së arritjes dhe vetëbesimit.

## **LOJA Nr. 24**      **Modelo dhe krijo**

### **Qëllimi i lojës**

Kjo lojë synon të zhvillojë kreativitetin e fëmijëve dhe aftësitë e tyre motorike fine përmes modelimit të argjilës. Ndërsa punojnë me duart e tyre, fëmijët mësojnë për teksturën, formën dhe strukturën e materialeve të ndryshme. Përdorimi i argjilës inkurajon fëmijët të krijojnë objekte unike dhe t'i dekorojnë ato me elementë

shtesë, duke forcuar imagjinatën dhe kreativitetin.

### **Kohëzgjatja: 15-20 minuta**

### **Çfarë ju nevojitet?**

Argjilë

Shkopinj të vegjël (ose mjete për modelim)

Opsionale: fasule, gjethe, misër, pupla, arra për dekorime.

### **Si ta zhvillon lojën?**

Jepini secilit fëmijë një pjesë argjile. Le të fillojnë të formojnë atë që duan.

Tregojuni fëmijëve se si mund të përdorin duart dhe shkopinj të vegjël për të krijuar forma dhe për të dekoruar objektet që ndërtojnë. Udhëzoni ata që të mendojnë për formën që duan të krijojnë dhe si do ta realizojnë atë.

Ndërsa modelojnë, inkurajoni fëmijët të flasin për krijimet e tyre:

Pyetini: Çfarë po krijoni? Si do ta realizoni objektin tuaj?

Flisni me ta për format e ndryshme që po krijojnë (cilindra, sfera, kuboidë) dhe çfarë ato i kujtojnë.

Nëse fëmijët më të vegjël kanë vështirësi në modelimin e objekteve specifike, ndihmohini të krijojnë forma të thjeshta. Ndërsa bëjnë këtë, flisni me ta për cilësitë e formave të krijuara dhe përse janë të rëndësishme.

### **Variacionet e lojës**

Për ta bërë lojën më emocionuese dhe kreative, ofroni fëmijëve materiale të tjera për të dekoruar krijimet e tyre, si fasule, gjethe, misër ose pupla. Kjo do t'u ndihmojë fëmijëve të kombinojnë materiale dhe të zhvillojnë një kuptim më të mirë të tekstit dhe teksturës.

Kërkojuni fëmijëve të krijojnë objekte të përditshme, si një gotë ose mbajtëse lapsash, dhe më pas ta dekorojnë atë me elementët që i ofroni.

### **Këshilla për prindërit**

Nëse fëmijët kanë nevojë për ndihmë, tregojuni hapat për të formuar objekte të thjeshta, si një top ose një cilindër.

Kjo do t'i ndihmojë të zhvillojnë aftësitë e tyre motorike.

Lejojini fëmijët të eksperimentojnë me formën dhe materialet. Në fund, çdo krijim është një arritje për ta dhe ndihmon në rritjen e vetëbesimit të tyre.

### **Përfitimet nga loja**

Zhvillimi i aftësive motorike fine dhe koordinimit sy-dorë.

Nxitja e kreativitetit dhe imagjinatës.

Përmirësimi i aftësisë për të planifikuar dhe realizuar një projekt.  
Zhvillimi i vetëbesimit dhe ndjenjës së arritjes.

## LOJA Nr. 25 Ngjyrosim zogjtë

### Qëllimi i lojës

Kjo lojë ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësitë e tyre motorike fine, kreativitetin dhe bashkëpunimin me njëritjetrin. Fëmijët do të kenë mundësinë të krijojnë një zog me letra shumëngjyrëshe, duke mësuar për ngjyrat dhe forma të ndryshme.

### Kohëzgjatja: 10-15 minuta

### Çfarë ju nevojitet?

Fletë letre me ngjyra të ndryshme

Ngjitës

Vizatim konturi të një zogu (për secilin grup)

### Si ta zhvilloni lojën?

Secilit grup prej 3-4 fëmijësh i jepet një fletë me konturin e një zogu dhe copa letre me ngjyra të ndryshme, të prera në forma të vogla (drejtkëndësha ose forma të tjera të lehta për t'u ngjitur).

Kërkojuni fëmijëve të ngjisin copat e letrës shumëngjyrëshe mbi konturin e zogut, duke krijuar zogun e tyre të bukur. Inkurajoni fëmijët të përdorin imagjinatën e tyre për ta zbukuruar sa më shumë zogun.

Lejojini fëmijët të punojnë së bashku si grup dhe të marrin vendime kolektive se si do ta zbukurojnë zogun e tyre.

### Variacionet e lojës

Pasi fëmijët të kenë përfunduar krijimet e tyre, mund të krijoni një histori për zogjtë e bukur që sapo kanë fluturuar për herë të parë dhe po eksplorojnë botën përreth tyre. Kjo e bën lojën më argëtuese dhe ndihmon në zhvillimin e aftësive të tyre gjuhësore.

Në vend të zogjve, mund të vizatoni kafshë të tjera, si një luan ose një kalë, dhe të siguroni fije për të imituar qimet e tyre. Kjo do t'i japë fëmijëve mundësinë të eksplorojnë materiale të ndryshme.

Kërkojuni fëmijëve të krijojnë një kolazh me materiale të ndryshme si gjethe, fasule, fije ose pupla. Secili grup mund të zgjedhë një temë dhe të punojë së bashku për të krijuar diçka unike.

### Këshilla për prindërit

Nëse fëmijët janë më të vegjël dhe e kanë të vështirë të ngjisin copa të vogla letre, priteni letrën në pjesë më të

mëdha dhe ndihmojini kur është e nevojshme.

Inkurajoni fëmijët të punojnë së bashku dhe të diskutojnë për zgjedhjet e tyre, kjo do t'i ndihmojë të zhvillojnë aftësi bashkëpunimi dhe kreativitet.

### Përfitimet nga loja

Zhvillimi i aftësive motorike fine përmes ngjitjes dhe prerjes së letrës.

Stimulimi i kreativitetit dhe imagjinatës përmes dekorimit të zogut dhe krijimit të historive.

Nxitja e bashkëpunimit dhe komunikimit mes fëmijëve.

## LOJA Nr. 26 Argëtim me lodrat dhe mjetet e mësimit

### Qëllimi i lojës

Kjo lojë ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësi të ndryshme duke përdorur lodra dhe materiale edukative të thjeshta dhe të përballeshme. Pjesëmarrësit mësojnë përmes lojës, zhvillojnë aftësitë e tyre mendore, fizike dhe sociale, dhe njëkohësisht përforcojnë kreativitetin dhe kuriozitetin për botën rreth tyre.

### Çfarë ju nevojitet

Lodra të thjeshta dhe mjete të bëra nga materiale lokale (p.sh. kukulla, topa, blloqe ndërtimi, puzzle, etj.)

Objekte të tjera si rroba për veshje ose aksesore për lojëra me role

Kartona, shkopinj, gurë të ngjyrosur ose letër për aktivitete artizanale

### Si ta zhvilloni lojën

Vendosni lodrat në zona të veçanta dhe inkurajoni fëmijët t'i përdorin ato në mënyra të ndryshme.

Mund të përdoren për ndërtimin e një kalaje me blloqe ose krijimin e një puzzle.

Jepni fëmijëve kostume dhe objekte të vogla për t'u veshur si personazhe të ndryshëm (mjek, shitës, prindër).

Lërinë të imagjinojnë dhe të luajnë histori të ndryshme.

Fëmijët mund të përdorin materiale të thjeshta si letër, ngjitës dhe ngjyra për të krijuar lodra të vogla ose artizanate që mund t'i marrin në shtëpi.

### Këshilla për prindërit

Inkurajoni fëmijët të luajnë dhe të krijojnë së bashku me ju. Përdorni materialet që keni në shtëpi për të ndërtuar lodra dhe mjete për lojëra edukative.

Përdorni lojërat e propozuara për të mësuar fëmijët tuaj rreth koncepteve të ndryshme si numrat, format, ose ngjyrat. Lojërat inkurajojnë zhvillimin e aftësive themelore që janë të nevojshme për shkollën.

**Përfitimet nga loja**

*Zhvillimi social.* Fëmijët mësojnë të bashkëpunojnë dhe të ndërveprojnë me të tjerët gjatë lojërave me role dhe aktiviteteve në grup.

*Zhvillimi i mendimit kreativ.* Përdorimi i objekteve të thjeshta për të krijuar histori ose ndërtime ndihmon në zhvillimin e imagjinatës.

*Aftësitë motorike.* Aktivitetet që kërkojnë manipulimin e objekteve ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë aftësitë motorike fine dhe koordinimin sy-dorë.

**LOJA Nr. 27** Kukullat për argëtim me pupeta**Qëllimi i lojës**

Kjo lojë i ndihmon fëmijët të zhvillojnë kreativitetin dhe aftësitë e tyre motorike duke krijuar kukulla të vogla për gishta. Ata do të mësojnë të përdorin duart për të bërë figura të vogla dhe pastaj do të luajnë me to, duke krijuar tregime dhe situata argëtuese.

**Çfarë ju nevojitet**

Karton

Gërshërë

Ngjitës

Fije për flokët

Lapsa me ngjyra ose lapsa me felt

**Si ta zhvilloni lojën**

Vizato konturet e kukullave të vogla mbi karton dhe pritini me kujdes me gërshërë.

Dekoroni fytyrat dhe trupat e kukullave duke përdorur lapsa me ngjyra.

Për flokët, pritini fijet në copa të vogla dhe ngjitini mbi kokën e kukullës.

Pritni dy vrima të vogla në fund të kukullës për të futur gishtat, që fëmijët të luajnë me kukullën si në një shfaqje.

Ndërsa tregoni histori, përdorni kukullat për t'i bërë personazhet e tregimit më të gjalla.

Fëmijët mund të krijojnë tregimet e tyre me kukullat dhe të zhvillojnë një shfaqje për shokët.

**Këshilla për prindërit**

Ndihmoni fëmijët në prerjen dhe ngjitjen e materialeve për të siguruar që nuk do të lëndohen.

Ftoni fëmijët të shpikin tregime për kukullat e tyre dhe t'i tregojnë për familjen ose shokët.

**Variacione të lojës**

Përveç kukullave, mund të krijoni forma kafshësh si zogj apo qengja duke ndjekur të njëjtën procedurë.

Pas krijimit të kafshëve për gishta, fëmijët mund të krijojnë skena ku kafshët ndërveprojnë me njëra-tjetrën.

**LOJA Nr. 28** Kukullat e gëzimit për duar**Qëllimi i lojës**

Kjo lojë ndihmon fëmijët të përfshihen në lojëra imagjinate dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre motorike, ndërsa krijojnë kukulla për duar dhe luajnë me to. Ata mësojnë të përdorin dorën për të lëvizur kukullat, duke zhvilluar kështu kreativitetin dhe aftësitë shprehëse.

**Çfarë ju nevojitet?**

Copa të ndryshme materialesh

Fije për qepje

Gjilpërë dhe marker për vizatim

**Si ta zhvilloni lojën?**

Vizato formën e një kukulle në një copë të palosur dy herë.

Prit formën dhe qepi të dy pjesët së bashku, por lëre të hapur pjesën e poshtme.

Pasi ta ktheni mbrapsht që fytyra të jetë në anën e jashtme, vizato ose qepi fytyrën dhe rrobat.

Ndërsa tregoni histori, përdorni kukullat për të përshkruar veprimet e personazheve.

Jepuni fëmijëve kukullat dhe kërkojuni t'i përdorin për të lëvizur, përplasur duart apo imituar veprime të thjeshta si përkulja.

**Këshilla për prindërit**

Nëse është e nevojshme, ndihmojini fëmijët gjatë qepjes së materialit për të siguruar që nuk lëndohen dhe që kukullat formohen siç duhet.

Lejojini fëmijë të shpikin histori dhe të ndërveprojnë me kukullat e tyre në mënyra krijuese.

**Variacione të lojës**

Për t'i bërë kukullat më të qëndrueshme, mbushini me oriz ose pambuk dhe qepi pjesën e poshtme.

Qepi rroba të vogla për kukullat, si shall, kapelë apo fustan.



## LOJA Nr. 29 Bëjmë kafshë te karta dhe luajmë me to

### Qëllimi i lojës

Kjo lojë ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësitë motorike fine, të përmirësojnë kreativitetin dhe të mësojnë rreth kafshëve të ndryshme. Ndërsa vizatojnë dhe ngjyrosin kafshët e tyre të preferuara, ata përfshihen në mësimin e koncepteve si madhësia, ngjyrat dhe habitatet e kafshëve.

### Çfarë ju nevojitet

Pjesë kartoni të trashë

Gërshërë për fëmijët

Lapsa me ngjyra ose marker

### Si ta zhvilloni lojën

Me një marker, vizato formën e kafshëve të ndryshme si një elefant, qen, mace, ose zog mbi karton.

Ndihmohini fëmijët të vizatojnë tiparet kryesore të kafshëve, si sytë, këmbët dhe bishtin.

Pritini konturet me gërshërë.

Kërkojuni fëmijëve të ngjyrosin kafshët e tyre duke përdorur lapsa me ngjyra ose markerë.

Ndërsa ata ngjyrosin, flisni për kafshën që po krijojnë: “Cilat kafshë jetojnë në pyll?”, “Çfarë hanë elefantët?”

### Për çfarë mund t'i përdorni kafshët prej kartoni?

Përdorini kafshët për të ilustruar histori. Për shembull, krijoni një histori për një elefant që udhëton në pyll ose një zog që fluturon lart mbi malet.

Kafshët prej kartoni mund të përdoren për të mësuar rreth madhësisë, ngjyrave dhe tingujve që kafshët bëjnë.

“Cila kafshë është më e madhe?”, “Cila kafshë është e verdhë?”, “Çfarë tingulli bën qeni?”

### Variacione të lojës

Përveç kafshëve, mund të prisni objekte të tjera, si shtëpi, makina ose lule, për të zgjeruar lojën.

Vizato një pyll ose një liqen mbi një copë kartoni dhe vendosni kafshët në mjedisin e tyre natyror për të krijuar një lojë më dinamike.

## LOJA Nr. 30 Bëjmë tupanë dhe eksperimentojmë me tinguj

### Qëllimi i lojës

Kjo lojë ndihmon fëmijët të mësojnë rreth tingujve dhe muzikës përmes krijimit të tupanëve të tyre. Ata

inkurajohen të eksperimentojnë me materialet dhe të dallojnë tingujt që krijohen nga objekte të ndryshme.

### Çfarë ju nevojitet

Shishe plastike (me përmasa të ndryshme)

Fasule të thata, oriz ose gurë të vegjël

### Si ta zhvilloni lojën

Merrni një shishe plastike të zbrazët dhe vendosni disa fasule, oriz ose gurë të vegjël brenda. Mos e mbushni shishen plotësisht, në mënyrë që objektet të lëvizin dhe të krijojnë tinguj.

Mbyllni kapakun fort për të siguruar që të mos hapet gjatë lojës.

Lejojini fëmijët të tundin tupanët e tyre dhe të dëgjojnë zhurmën që krijohet. Pyetni: “Cili tupan tingëllon më fort?”,

“A bën më shumë zhurmë një shishe me gurë apo me fasule?”

Fëmijët mund të krahasojnë zhurmën e tupanëve të ndryshëm duke përdorur materiale të ndryshme brenda shisheve.

### Për çfarë mund t'i përdorni tupanët?

Përdorni tupanët për të krijuar ritme të ndryshme dhe për të shoqëruar këngët e fëmijëve gjatë kohës së këndimit dhe vallëzimit.

Fëmijët mund të eksperimentojnë me materialet që vendosin në shishe. Provoni të mbushni një shishe me pëlhurë dhe pyesni fëmijët: “A do të bëjë pëlhura zhurmë si gurët?” Kjo ndihmon ata të zhvillojnë njohuritë e tyre mbi tingujt dhe materialet.

### Variacione të lojës

Merrni një enë kartoni dhe mbusheni me objekte si kapakë shishesh plastike. Mbylleni me shirit ngjitës për të shmangur që objektet të dalin jashtë.

Lejojini fëmijët të dekorojnë tupanët e tyre me fije, pëlhura ose lapsa ngjyrash për ta bërë lojën më argëtuese dhe personale.

## LOJA Nr. 31 Shkopinj të muzikorë

### Qëllimi i lojës

Kjo lojë ndihmon fëmijët të zhvillojnë ndjeshmërinë ndaj ritmit dhe tingujve muzikorë, duke i lejuar të eksperimentojnë me shkopinjtë ritmi. Ata mësojnë të dallojnë zhurmat dhe ritmet e ndryshme, ndërsa zhvillojnë aftësitë e tyre motorike dhe koordinimin.

### Çfarë ju nevojitet

Një shkop druri (si bambu ose një lloj druri tjetër i fortë)

Mjete për prerjen dhe përpunimin e drurit (sharrë, lima, letër zmerile)

### Si ta zhvilloni lojën

Prisni shkopin në copa të vogla prej rreth 12 cm. Përdorni lima dhe letër zmerile për të zbutur skajet, duke siguruar që të jenë të lëmuara dhe të sigurta për t'u përdorur nga fëmijët.

Nëse nuk keni mjetet e nevojshme, kërkoni ndihmë nga një marangoz lokal ose nga prindërit e fëmijëve për të përgatitur shkopinjtë.

Fëmijët mund të godasin shkopinjtë së bashku për të krijuar tinguj të ndryshëm. Eksperimentoni me ritme të buta dhe të forta, dhe flisni me fëmijët për zhurmat që prodhojnë.

Mund të përdorni shkopinjtë të bërë nga lloje të ndryshme druri për të krahasuar tingujt e ndryshëm që ato prodhojnë.

### Për çfarë mund t'i përdorni shkopinjtë muzikorë

Përdorni shkopinjtë për të luajtur ritme të ndryshme gjatë këngëve apo kërcimeve.

Shkopinjtë mund të përdoren për të diskutuar për zhurmat e ndryshme që krijohen nga druri ose materiale të tjera. Përdorni shkopinjtë për të zhvilluar një ndjenjë për ritmin dhe muzikën te fëmijët.

### Variacione të lojës

Ju mund të vizatoni ose të gdhendni linja në shkopinjtë për të krijuar tinguj më interesantë kur fërkohen së bashku. Shishe plastike të zbrazëta ose objekte të tjera të ngjashme mund të përdoren gjithashtu për të krijuar ritme duke i goditur së bashku.

### Këshilla

Sigurohuni që fëmijët t'i godasin shkopinjtë butësisht për të shmangur thyerjen e tyre. Kontrolloni shpesh shkopinjtë për çështje sigurie, dhe zëvendësoni ato nëse dëmtohen.

## LOJA Nr. 32

## Dauilla e zhurmave

### Qëllimi i lojës

Kjo lojë ndihmon fëmijët të eksplorojnë tingujt dhe ritmet muzikore, duke përdorur daulle të krijuara nga materiale të përditshme. Ata mësojnë të dallojnë ritme dhe të përfshihen në aktivitete muzikore në një mënyrë argëtuese dhe krijuese.

### Çfarë ju nevojitet?

Një kuti kartoni e zbrazët (preferohet një kuti me karton të trashë për tingull më të fortë)

Shirit ngjitës

Shkopinj druri (ose lapsa të gjatë të drurit)

Letër me ngjyra, lapsa me ngjyra, ngjitës

### Si ta zhvilloni lojën?

Mbyllni kutinë e zbrazët prej kartoni me shirit ngjitës për ta bërë të qëndrueshme.

Dekoroni kutinë me letër me ngjyra ose lapsa me ngjyra për ta bërë më tërheqëse për fëmijët.

Dauilla është gati për përdorim!

Përdorni duart ose shkopinjtë për të rrahur dauillen dhe krijoni ritme të ndryshme. Eksperimentoni me goditje të buta dhe të forta për të krijuar tinguj të ndryshëm.

Lejojini fëmijë të krijojnë ritmet e tyre dhe t'i ndjekin ato të njëri-tjetrit.

### Për çfarë mund ta përdorni dauillen?

Përdorni tingujt e dauilles për të shtuar efektet në kohën e tregimeve, për shembull për të imituar tingujt e ecjes ose të një feste.

Fëmijët mund të mësojnë ritme dhe të mësojnë të bashkëpunojnë me të tjerët për të krijuar tinguj dhe muzikë.

### Variacione

Në vend të kartonit, mund të përdorni kanaçe të zbrazëta (me kujdes që të mos kenë skaje të mprehta) për të krijuar tinguj të ndryshëm.

Përdorni tiganë, tenxhere, ose madje edhe lugë dhe pjata për të krijuar një "orkestër" me objekte të përditshme.

### Këshilla

Sigurohuni që fëmijët të përdorin shkopinjtë dhe dauillen me kujdes për të shmangur ndonjë dëm në kuti ose në shkopinjtë.

Kontrolloni materialet për të siguruar që janë të sigurta për përdorim nga fëmijët e vegjël.

## LOJA Nr. 33

## Krijo topin dhe unazën

### Qëllimi i lojës

Kjo lojë ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësitë motorike dhe koordinimin përmes lojërave me hedhje dhe kapje. Po ashtu, u ofron një mundësi për të zhvilluar kreativitetin e tyre duke ndihmuar në krijimin e lodrave me materiale të thjeshta.

### Çfarë ju nevojitet?

Materiale: Pëlhurë (material të butë që mund të qepet)

Vegla: Gjilpërë, fije, gërshërë

Material për mbushje: Lesh, fasule, ose mbështjellje plastike të grumbulluara

### Si ta përgatisni?

Vizatoni dy drejtkëndësha identikë në një copë dhe pritini ato.

Qepni së bashku anët e gjata, duke lënë anët e shkurtra të hapura.

Përmbysni copën, mbusheni me material dhe më pas qepni anët e mbetura për të formuar unazën.

Vizatoni dhe pritini dy gjysma të rrumbullakëta në pëlhurë.

Qepni gjysmat së bashku, duke lënë një hapësirë për mbushje.

Mbushni topin me lesh ose fasule dhe qepni hapësirën e mbetur.

### Për çfarë aktivitete mund t'i përdorni?

Përdorini unazat për një lojë me shtizë: fëmijët mund të përpiqen t'i vendosin unazat mbi një shkop ose shtizë.

Topat mund të përdoren për lojëra të hedhjes dhe kapjes.

Ilustroni historitë duke përdorur këto objekte për të bërë më interesante seancat e tregimeve.

### Variacione

Përveç topave dhe unazave, mund të krijoni edhe figura të tjera si kukulla ose peshq. Thjesht vizatoni, prisni dhe qepni format e dëshiruara, më pas mbushini me material dhe qepni pjesën e hapur.

Vizato formën e një peshku, qep dy pjesë së bashku dhe mbush me material për të krijuar një lojë të re për fëmijët.

### Këshilla

Mbani gjithmonë nën mbikëqyrje fëmijët teksa përdorin gjilpërat ose gërshërët për të shmangur lëndimet.

Përdorni materiale të buta dhe të sigurta për t'u siguruar që lodrat të jenë të përshtatshme për fëmijët e vegjël.

## LOJA Nr. 34

## Puzzle nga kartoni

### Qëllimi i lojës

Kjo lojë ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësitë motorike dhe njohuritë e tyre për ngjyrat dhe format përmes krijimit të një puzzle. Është një aktivitet argëtues dhe edukativ që përfshin përqendrimin, zgjidhjen e problemeve dhe bashkëpunimin në grup.

### Çfarë ju nevojitet?

**Materiale:** Karton, lapsa me ngjyra ose bojra, gërshërë.

### Si ta përgatisni?

Vizato një figurë të thjeshtë (si një kafshë, shtëpi ose pemë) mbi një copë kartoni.

Ngjyrose figurën duke përdorur lapsa me ngjyra ose bojra për ta bërë më tërheqëse.

Prit figurën në pjesë me forma dhe madhësi të ndryshme për të krijuar pjesët e puzzle-it.

Mund të filloni me copa më të mëdha për fëmijët më të vegjël dhe të zvogëloni copat për fëmijët më të rritur.

### Për çfarë aktivitete mund ta përdorni?

*Zhvillimi i aftësive motorike.* Fëmijët do të praktikojnë përdorimin e duarve për të marrë dhe vendosur copat e puzzle-it në vendin e duhur.

*Njohja e ngjyrave dhe formave.* Diskutoni me fëmijët ngjyrat dhe format e ndryshme gjatë lojës për t'i ndihmuar ata të përforcojnë njohuritë.

*Koha e lojës së lirë.* Puzzle mund të përdoret si një aktivitet individual ose në grup për t'u siguruar që fëmijët të argëtohen dhe mësojnë njëkohësisht.

### Këshilla

Përgatitni puzzle me nivele të ndryshme vështirësie sipas moshës dhe aftësive të fëmijëve me copa më të mëdha për fillestarët dhe më të vogla për fëmijët që kërkojnë më shumë sfidë.

Nëse fëmijët e kanë të vështirë të vendosin copat në vendin e duhur, përdorni një model vizual si udhëzues.

### Variacione

Vizato dhe prit puzzle që përmbajnë numra ose shkronja për t'i ndihmuar fëmijët të mësojnë alfabetin ose numërimin gjatë lojës.

Përveç kafshëve, krijoni figura si lule, makina ose njerëz, dhe organizoni lojëra të ndryshme sipas preferencave të fëmijëve.

## LOJA Nr. 35

## Bloqe ndërtimi

### Përshkrimi i lojës

Kjo lojë ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësitë motorike dhe njohuritë për format dhe sasinë, ndërsa ndërtojnë struktura të ndryshme me blloqe ndërtimi të thjeshta prej kartoni.

### Çfarë ju nevojitet?

Materialet: Kuti të vogla kartoni (ose një të madhe), letër gazete, shirit ngjitës, pëlhurë ose lapsa me ngjyra për dekorim

### Si ta përgatisni?

Mbushni kutitë e vogla kartoni me letra të ngjeshura për t'i bërë më të forta dhe më të qëndrueshme. Mbyllni kutitë dhe ngjitini mirë me shirit ngjitës.

Ngjyrosni kutitë ose dekoroni ato me copa pëlhere për t'i bërë më tërheqëse për fëmijët.

Sigurohuni që blloqet të kenë forma të ndryshme për të sfiduar kreativitetin e fëmijëve gjatë ndërtimit.

### **Për çfarë aktivitete mund t'i përdorni?**

Fëmijët mund të vendosin blloqet njëra mbi tjetrën për të ndërtuar kulla ose struktura të tjera, duke mësuar për balancën dhe qëndrueshmërinë.

Diskutoni me fëmijët për format dhe madhësitë e ndryshme të blloqeve që po përdorin. Flisni për numrat dhe sasi, si dhe konceptet e më shumë e më pak.

Fëmijët mund të luajnë lirshëm dhe të krijojnë struktura të ndryshme duke përdorur blloqet e tyre të ndërtimit.

### **Këshilla**

Nëse dëshironi që blloqet të jenë më të qëndrueshme, mund të kërkonin ndihmën e një marangozit lokal për të krijuar blloqe prej druri në forma të ndryshme si kube, cilindër, prizma, etj.

Nëse nuk keni kuti të vogla, përdorni një të madhe duke e shtypur dhe vizatuar formën e një blloku ndërtimi mbi të. Priteni dhe vullojeni me shirit ngjitës për të krijuar një bllok ndërtimi të madh për lojë.

### **Variacione**

Përdorni karton të madh për të krijuar blloqe më të mëdha dhe më sfiduese për ndërtimin e strukturave.

Eksperimentoni me forma të ndryshme të blloqeve si trekëndësha ose drejtkëndësha për t'i ndihmuar fëmijët të mësojnë më shumë rreth gjeometrisë dhe ekuilibrit.

## LOJA Nr. 36

## Gjej çiftet e sakta

### **Përshkrimi i lojës**

Kjo lojë ndihmon fëmijët të zhvillojnë kujtesën dhe aftësinë për të identifikuar lidhjet mes objekteve të ngjashme.

Fëmijët do të luajnë për të gjetur kartat me figura që përputhen, duke përmirësuar njohjen vizuale dhe mendimin logjik.

### **Çfarë ju nevojitet?**

#### **Materialet:**

Copëza kartoni

Gërshërë

Lapsa ose stilolapsa me ngjyra

### **Si ta përgatisni?**

Pritni disa katrorë nga kartoni për të krijuar kartat e memories.

Në çdo palë karta, vizatoni dy figura identike si kafshë, objekte, ose njerëz. Përsëriteni këtë për disa sete.

### **Si luhet?**

Përziejini kartat dhe vendosini në dysheme me anën e përparme poshtë.

Secili fëmijë kthen dy karta në çdo herë për të gjetur çiftet që përputhen.

Nëse çiftet përputhen, fëmija i mban kartat; nëse jo, kartat kthehen përsëri poshtë.

Loja përfundon kur të gjitha çiftet janë gjetur. Fiton fëmija që ka më shumë çifte.

### **Për çfarë aktivitete mund t'i përdorni?**

Loja ndihmon fëmijët të zhvillojnë kujtesën dhe të praktikojnë njohjen e objekteve sipas formës, ngjyrës dhe tipareve të tjera të përbashkëta.

### **Variacione**

Në vend të kartave me figura identike, mund të përdorni objekte që lidhen mes tyre, si një makinë dhe një kamion, ose një shtëpi dhe një fshat. Kjo i mëson fëmijët konceptet e lidhura dhe përmirëson aftësinë e tyre për të menduar në mënyrë logjike.

Për të rritur nivelin e vështirësisë, përdorni më shumë karta ose krijoni figura me ngjyra dhe forma më të ngjashme për t'i sfiduar fëmijët.

### **Këshilla**

Për fëmijët më të vegjël, filloni me më pak çifte për të mos i mbingarkuar.

Nëse një fëmijë ka vështirësi të gjejë një çift, inkurajoni fëmijët të ndihmojnë njëri-tjetrin.

## LOJA Nr. 37

## Maskat e kafshëve

### **Qëllimi**

Të zhvillohen aftësitë kreative të fëmijëve duke bërë dhe përdorur maska të kafshëve. Kjo lojë inkurajon imagjinatën, ndërveprimin dhe argëtimin përmes lojës së roleve.

### **Materialet që ju nevojiten**

Copëza kartoni: Për të bërë maskat

Një fill ose elastik: Për të mbajtur maskën në vend

Gërshërë: Për të prerë maskën

Lapsa, stilolapsa ose bojra: Për ngjyrosjen e maskës



Copa të vogla letre me ngjyra ose pëlhure, fije leshi: Për dekorimin e maskës dhe imitimim e qimeve të kafshës

### Si ta përgatisni?

Vizatoni konturin e fytyrës së një kafshe (si majmun, luan, elefant) mbi kartonin tuaj dhe më pas priteni me gërshërë.

Vizatoni dhe prisni dy rrethe të vogla në maskë për sytë e fëmijës, në mënyrë që të mund të shohë përmes tyre.

Ngjitni një fill ose elastik në të dy anët e maskës, në mënyrë që fëmija ta vendosë atë mbi kokë.

Kërkojuni fëmijëve ta ngjyrosin maskën dhe ta zbukurojnë me copa letre me ngjyra ose fije leshi për të imituar qimet e kafshës.

### Për çfarë aktivitete mund ta përdorni?

Fëmijët mund të zbukurojnë maskat duke përdorur letër me ngjyra ose fije leshi. Ky aktivitet i ndihmon ata të zhvillojnë aftësitë motorike dhe kreative.

Pasi të kenë bërë maskat, fëmijët mund t'i përdorin ato për të inskenuar një histori të shkurtër me kafshët që kanë krijuar. Kjo ndihmon me zhvillimin e të folurit dhe aftësive për shprehjen emocionale.

Organizoni lojëra ku fëmijët veshin maskat dhe imitojnë lëvizjet e kafshëve që kanë zgjedhur. Kjo ndihmon me zhvillimin fizik dhe njohjen e kafshëve.

### Variacione

Ju mund të krijoni maska me fytyra njerëzore (si një djalë ose vajzë) për të ndryshuar lojën dhe për t'u dhënë fëmijëve mundësinë të inskenojnë lojëra sociale.

Për një sfidë më të madhe, fëmijët mund të krijojnë maska të kafshëve më të rralla si zebra ose gjirafa.

### Këshilla

Për fëmijët më të vegjël, mund të përgatisni maska më të thjeshta dhe të ndihmoni në prerje ose ngjitje.

Krijoni pjesë që mund të hiqen ose shtohen, si syze, kapele ose veshje, për ta bërë aktivitetin më të personalizuar dhe argëtues.



## **Bibliografia**

- Almon, J. (2003). *The Vital Role of Play in Early Childhood Education*. Waldorf Early Childhood Association of North America.
- American Psychiatric Association. (2013). *Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders (DSM-5)*. American Psychiatric Publishing.
- Berk, L. E. (2018). *Infants, Children, and Adolescents*. Pearson Education.
- Bronfenbrenner, U. (1979). *The Ecology of Human Development: Experiments by Nature and Design*. Harvard University Press.
- Derman-Sparks, L., & Edwards, J. O. (2019). *Anti-Bias Education for Young Children and Ourselves*. NAEYC.
- Epstein, J. L. (2018). *School, Family, and Community Partnerships: Your Handbook for Action*. Corwin Press.
- Gardner, H. (2011). *Frames of Mind: The Theory of Multiple Intelligences*. Basic Books.
- Gordon, T., & Browne, K. (2013). *Beginnings and Beyond: Foundations in Early Childhood Education*. Wadsworth Cengage Learning.
- Greene, R. W. (2014). *The Explosive Child: A New Approach for Understanding and Parenting Easily Frustrated, Chronically Inflexible Children*. HarperCollins.
- Jensen, E. (2005). *Teaching with the Brain in Mind*. ASCD.
- Kolb, D. A. (1984). *Experiential Learning: Experience as the Source of Learning and Development*. Prentice Hall.
- Santrock, J. W. (2020). *Child Development*. McGraw-Hill Education.
- Siegel, D. J., & Bryson, T. P. (2011). *The Whole-Brain Child: 12 Revolutionary Strategies to Nurture Your Child's Developing Mind*. Delacorte Press.
- Sousa, D. A. (2011). *How the Brain Learns*. Corwin Press.
- Trawick-Smith, J. (2014). *Early Childhood Development: A Multicultural Perspective*. Pearson.
- UNICEF. (2009). *Early Childhood Development Kit: Facilitator's Guide*. UNICEF.
- Vygotsky, L. S. (1978). *Mind in Society: The Development of Higher Psychological Processes*. Harvard University Press.